

LISTA E RE

Ish-pronarët, emrat e përfituesve nga fondi financiar e fizik

ATP shpërndan 206 mijë euro dhe 56 hektarë me objekt kompensimin financiar dhe kompensimin fizik nga fondi i tokës në dispozicion

► FAQE 10

EKSKLUZIVE

DOSJA DANEZE PER JETMIR KASTRATIN, SI U ZBULUA GRUPI I KOKAINES

Përgjimet në automjete, dënimi i Kastratit në Norvegji e perandoria e pasurisë në emër të kunatit

► FAQE 13

ELTON QYNO

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI IX - NR. 180 (2702)

E MËRKURË, 31-07-2019

www.shqiptarja.com

PROJEKTLIGJI

JA SI NDRYSHOJNE RREGULLAT PER KASAT FISKALE

Si do të funksionojë sistemi i ri me raportimin në kohë reale të shitje-blerjeve. Çfarë aparaturash duhen për t'u përshtatur me aplikacionin e ri të detyrueshëm. Sa kushton detyrimi i regjistrimit të nënshkrimit elektronik që duhet për faturat e reja, kush janë kufijtë për biznesin e vogël dhe të madh. Sot prezantohet projekti

GENC KONDI

► FAQE 9

BASHKIA E TIRANES

BETOHET ERION VELIAJ: KAM RENE NE DASHURI ME BASHKINE!

Konstituohet Këshilli i ri Bashkiak, Tonin Gogu zgjidhet kryetar. Kryeministri Rama: Mos harroni si e gjetëm Tiranën në kohën e Bashës

► FAQE 5



PASOJAT E REZISTENCËS

Mziu dhe Ademi 1 vit burg nëse nuk lëshojnë zyrat

Pasoja penale për kryebashkiakët e PD-LSI që kryejnë funksione pas betimit të të zgjedhurve të rinj

ADRIATIK DOÇI

► FAQE 6

KRYEBASHKIAKU I DURRESIT

Dakos dhe familjes së tij i ndalohet hyrja në SHBA

Departamenti i Shtetit: Eshhtë përfshirë në raste madhore korrupsioni. Basha: Një lajm i mirë dhe i keq njëkohësisht

► FAQE 8



PIKË E ZEZË

Tani Meta mendon si Rama: Në zgjedhje merr pjesë vetëm ai që dëshiron

Kur Ilir Meta vendosi në mënyrë të njëanshme, më 10 qershor, në kulmin e fushatës elektorale, të anulonte datën e zgjedhjeve të 30 qershorit, motivi kryesor ishte sepse, sipas tij, nuk kishim të bënim me një votim demokratik, pasi opozita kishte vendosur të mos merrte pjesë në to.

vijon në faqen 3

ANALIZA 6-MUJORE

RAMA: S'KAM KOHE TE PRES BASHEN, TEATRI I RI DO BEHET



Kryeministri: Gati njësia super speciale për të 'fortët' e rrugëve, të gjejnë vrimë ku të futen

► FAQE 2

NJESIA SPECIALE

Artan Hoxha: Ja si do funksionojë njësia speciale për "të fortët"

► FAQE 3

KRIZA POLITIKE

Basha kundër 13 Tetorit, Meta: Kush s'do, të dalë me spektatorët

Presidenti: Lërin pushimet dhe alibitë, dialog për zgjidhjen e krizës, pa zgjedhje vendore gjithëpërfshirëse s'ka negociata

► FAQE 3

FLET PËR REPORT TV

Tërmetet, sizmologu grek: S'kam folur kurrë për Ballkanin

"Presidenti juaj është keqinformuar!" Meta insiston: Lajmi për tërmetin apokaliptik është i vërtetë

► FAQE 4

FILLON EKSTRADIMI

U lirua nga gjyqtari Miri, "i forti" i Burrelit kapet në Londër

Zbardhet dosja e plotë e Gentian Dodës nga korrupsioni i Shkëlqim Mirit e telefoni në burg

► FAQE 13

Rama: S'kam kohë të pres Bashën, Teatri i ri do bëhet

Kryeministri Edi Rama: Gati njësia super speciale për të 'fortët' e rrugëve, të gjejnë vrimë ku të futen

Kryeministri Edi Rama ishte dje për 120 minuta përballë gazetarëve për të folur për krizën politike, ekonominë, objektivat, çështjen e teatrit etj. Duke u ndalur tek kriza politike e provokuar nga PD-LSI, Rama u shpreh se është gati që të negocioj me opozitën vetëm për reformën zgjedhore. "Jam gati që të diskutoj për reformën zgjedhore sipas rekomandimeve të OSBE-së dhe porosisë së lënë nga Këshilli Europian, palët negociojnë rregullat e lojës, jo lojën. Ka mbaruar historia e shpikjeve apo karamelave, qofte te daja nuk ka më, se daja ka vdek në 30 qershor. Partitë duhet të futen në lojë dhe populli vendos kush fiton apo humbet. Akuzat e opozitës? Kam punë shumë më të rëndësishme për të bërë sesa të reagoj për akuzat e opozitës", tha ai. Kryeministri Rama mohoi që të ketë një iniciativë të ndërkombëtarëve për një komunikim me Bashën për zgjidhjen e krizës politike. Ai ripërsëriti ftesën për dialog, por shtoi se nuk ka kohë për t'i prituri. "Jo asnjë komunikim me Bashën përmes ndërkombëtarëve. Situata nuk mund të vijojë të marrë energjitë e mia dhe tonat për këtë çështje. Ne e kemi dhënë qëndrimin, jemi gati të dialogojmë në çdo moment me opozitën jashtë parlamentare, por jo të negociojmë asgjë që lidhet me vullnetin e popullit të shprehur me votë. Nuk jam gati të harxhoj kohën me këtë muhabet çdo ditë. Ka gjëra më të rëndësishme për mua sot sesa të pres Bashën apo Kryemadhin që të kandisen për të folur. Nuk kam asnjë paragjykim asnjë kusht, duan të ulen dhe të diskutojnë të ardhmen, 2021 është shumë afër sesa ç duket atyre dhe nëse ata vijnë kështu, edhe disa muaj, 2021 e kanë paketuar sërish me duart e tyre", pohoi Rama.

PËR ÇËSHTJEN E TEATRIT

Kryeministri Edi Rama tha se debati për Teatrin Kombëtar duhet të ishte mbyllur 20 vite më parë, ndërsa kishte një përgjigje për të gjithë ata që e akuzojnë për trashëgiminë kulturore, protestuesit dhe opozitën. "Godina e Teatrit nuk është një çështje verbërie apo indiference, por realiteti, një godinë e ndërtuar nga ushtria italiane me material të përkohshëm, jo për të qenë teatër kombëtar. Nuk ka qenë aty teatri me planin italian apo pas luftës. Ka mbetur gjë e përkohshme gjithë jetën si



Për Bashën

"Nuk jam gati të harxhoj kohën me këtë muhabet çdo ditë. Ka gjëra më të rëndësishme për mua sot sesa të pres Bashën apo Kryemadhin që të kandisen për të folur".

Paralajmërimi

"Kemi gati një njësi super speciale, që do të merret me të gjithë të fortët e rrugëve, ose të lagjeve ose të qyteteve. Duhet të përgatiten për t'u fshehur në vrima që duhet të jenë shumë-shumë të ngushta".

rezultat i pamundësive, sot është e degraduar, është e pariparueshme. Nëse do të kishte

vlerë nga pikëpamja arkitektonike dhe nëse do të i kishte hapësirat për teatër atëherë

Frika nga SPAK? Rama-Metës: Nuk është çështje Mic Sokolash...

Ipyetur nëse ka frikë nga SPAK-u, në përgjigjen e tij kishte edhe një përgjigje për Metën që e akuzon për kapje të drejtësisë. "As në ëndërrën më të keqe nuk e kam parë opozitën e këtij vendi të katandiset sikur është bërë dhe ju jeni në të drejtën tuaj të mendoni se kjo që them unë është sikur. Të thuash që mund të kapen SHBA-BE se ka një forcë të errët dhe se e gjithë kjo mund të ndodhë në Shqipëri, janë qesharake në rastin më të mirë, dhe shqetësuese në rastin më të keq. Kjo nuk është çështje frike dhe trimërie, as çështje Mic Sokolash, çështje veprash. Fjalët janë njëra anë, veprat janë ana tjetër. Unë kam qenë i vendosur për reformën në drejtësi. Ju keni parë shembull, aty ku hyn drejtësia ne hapin rrugën. Nuk është çështja të them, kam skam frikë, jam trim, të dal me rroba banje ti vërsulem ambasadash amerikane", pohoi Rama.



Rama: Ja çfarë më tha Merkel për reformën në drejtësi

Rama ka treguar gjatë konferencës për mediat se çfarë kishte deklaruar kancelarja Merkel për Shqipërinë gjatë samitit të Poznanin në Poloni. "E vërtetë që Shqipëria nuk ka Kushtetuese, por është rezultat i Vettingut, të cilin parlamenti i Shqipërisë edhe partnerët e Shqipërisë e kanë kërkuar me forcë. Atëherë ky është një moment tranzitor që kjo situatë është sukses i një procesi si Vetingu apo dështimi i procesit të reformës në drejtësi" tha Rama duke cituar sipas tij Merkelin. "Kjo është farsë e atyre që nuk duan që Gjykata Kushtuese të bëhet kurrë dhe që kanë abuzuar shumë me mungesën e saj", tha ai duke shigjetuar Metën dhe opozitën.

Paketa anti-shpifje

Edi Rama:
E rakorduar me OSBE-në, në shtator në parlament

Paketa anti-shpifje ka ngjallur shumë debat në vend, ndërsa kryeministri Rama tha se drafti është dakordësuar me OSBE-në dhe në shtator do të futet në parlament. "I kemi rakorduar të gjitha me OSBE-në për ligjin e shpifjes, që është në proces. E kemi harmonizuar ligjin me OSBE-në dhe në shtator do të futet në procedurë. Është punuar me ekspertë të OSBE-së", tha ai.



Vlerësimi

Rama thumbon Haradinajn:
Dorëheqja ishte një lëvizje taktike

Kryeministri Rama u shpreh se vlerëson Haradinajn për kontributin e dhënë gjatë luftës në Kosovë, ndërsa dorëheqjen e tij e konsideroi një lëvizje taktike. "Është gjëja më normale më duket mua, se te lufta e UÇK-së përfshihet dhe Ramush Haradinaj dhe jep apo jo dorëheqjen është një çështje politike dhe taktike. Në raport me luftën unë e konsideroj Ramush Haradinajn dhe Jakup Krasniqin si anëtarë të një lufte çlirimtare, e cila nuk mund të zhbëhet dhe as nuk mund të tjetërsohet nga këto akuza", tha ai.

NJËSIA E RE SUPER SPECIALE

Kreu i qeverisë njoftoi dje se është gati njësia speciale që do të godasë ata që ai i cilësoi si të 'fortët' e rrugëve dhe lagjeve. Rama shtoi se nuk do të ketë më efektive mbi 55-vjeç në trupën e policisë. "Shifrat e kriminalitetit

tregojnë se nuk jemi afektuar nga 6 muajt e revolucionit imagjinar antishtet dhe faktikisht vërejmë me kënaqësi që përtej ekranit të okupuar me gjithë krahura politike e Tiranës janë finalizuar nga Forca e Ligjit 10 operacione më



Rama

Zbulon bisedën me Presidentin francez:
Kam një marrëdhënie të afërt...

Kryeministri Rama zbuloi se çfarë kishte biseduar me Presidentin francez pak ditë më parë në telefon. "Për sa i përket bisedës asnjëherë nuk i ndaj nëse nuk janë formale dhe të dakordësuara për t'u ndarë me publikuan. Me Macron kam një marrëdhënie më të afërt sesa me shumë të tjerë. Kërkoj të flasë me mua rreth një orë apo diçka më shumë dhe zgjati shumë dhe u detyrova të shkoj me vonesë në asamble. Folëm për Evropën dhe rajonin, temat që diskutojmë gjithmonë".

shumë se një vit më parë, plot 20 operacioni, janë goditur 12 grupe kriminale dhe është sekuestruar pasuri 47.2 mln euro. Për sa i përket kriminalitetit të rrugës janë të qëndrueshme në progres, mund të kishte qenë më mirë nëse policia nuk do ishte marrë me lëvizjen antishtet. Vetingu në polici ka nisur, ka filluar verifikimi për 45 dosjet e para. Reformë për uljen e moshës mesatare në polici nga 55-65 vjeç. Nuk mund të ketë në trupën e policisë punonjës mbi 55-vjeç, rrugëdalja do të jetë kuptimplotë financiarisht. Kemi gati një njësi super speciale, që do të merret me të gjithë të fortët e rrugëve, ose të lagjeve ose të qyteteve. Ajo që e kam anoncuar disa kohë më parë dhe që do të jetë pjesë e presionit të policisë kundër këtyre tipave, që nëse do të vendosin të qëndrojnë në Shqipëri duhet të përgatiten për t'u fshehur në vrima që duhet të jenë shumë-shumë të ngushta, përndryshe nuk do të kenë mundësi të marrin frymë" tha ai.



PIKË E ZEZË

Tani Meta mendon si Rama: Në zgjedhje merr pjesë vetëm ai që dëshiron

vijon nga faqja 1

Ndërsa Edi Rama këmbëngulte duke thënë se zgjedhjet ishin demokratike, pasi zgjedhja për t'i bojkotuar ishte vendosur lirisht nga opozita. Debati mbi zgjedhjet, pas një muaji e gjysmë, është përmbytur krejtësisht. Në fakt, sot Ilir Meta mendon saktësisht si Edi Rama. Pyetjes se çfarë mendon për vendimin e PD-së për të bojkotuar edhe zgjedhjet

(virtuale) të 13 tetorit, sot Meta iu përgjigj: "Kush ka dëshirë, të regjistrohet; kush ka dëshirë të mos regjistrohet, të dalë me spektatorët. Edhe opozita ta ketë të qartë që nuk mund të rrijë larg nga problemet dhe të mjaftohet vetëm me denoncimet". Pra, zgjedhjet e 13 tetorit, sipas Metës, janë të ligjshme edhe pa pjesëmarrjen e Partisë Demokratike dhe të cilësdo forcë tjetër politike që do të zgjidhte të mos regjistrohej, duke përfshirë Partinë So-



cialiste, e cila, në fakt, nuk e njeh atë datë. I vetmi lider partie që ka njoftuar se do të marrë pjesë në zgjedhjet e 13 tetorit është gruaja e Ilir Metës. Kështu, për të qenë "zgjedhje demokratike dhe

gjithëpërfshirëse", sipas presidentit tonë të Republikës, kushti i vetëm që kërkohet sot është që Ilir Meta të jetë dakord dhe të marrë pjesë LSI. Një formë e re kjo e demokracisë familjare.

Basha kundër 13 Tetorit, Meta: Kush s'do, të dalë me spektatorët

Në kulmin e debateve për krizën politike, Presidenti Ilir Meta në orën 14:15 të pasdites së djeshme doli në një deklaratë për mediat ku njoftoi se ka krijuar forumin 'Unë jam Arbëresh'. Më pas kreu i shtetit iu përgjigj çështjeve politike mbi krizën, dekretin e tij për zgjedhjet e 13 Tetorit, por edhe integrimin. Presidenti pak ditë para zgjedhjeve të 30 Qershorit dekretoi 13

Presidenti: Lërimi pushimet dhe alibitë, dialog për zgjidhjen e krizës, pa zgjedhje vendore gjithëpërfshirëse s'ka negociata

Tetorin si datë zgjedhjesh lokale, por Basha është shprehur se nuk futet në zgjedhje me Ramën dhe pa qeveri tranzitore. Por Meta dje kishte një përgjigje për Bashën duke thënë se kush do të

marrë pjesë, ata që nuk duan të dalin me spektatorët. Ky ishte edhe argumenti i kryeministrit Edi Rama, i cili nuk u tërhoq nga zhvillimi i zgjedhjeve në 30 qershor, por në atë kohë Meta

kishte një tjetër qëndrim, sipas të cilit zgjedhjet nuk mund të mbaheshin pa opozitën. "Jam 1000% i bindur që zgjedhje të ligjshme janë ato të 13 Tetorit, kush ka dëshirë të regjistrohet,

kush ka dëshirë të mos regjistrohet, të dalë me spektatorët. Edhe opozita ta ketë të qartë që nuk mund të rrijë larg nga problemet dhe të mjaftohet vetëm me denoncimet. Në zgjedhje daneze nuk mund të presim. Kam qenë i hapur edhe Presidenti të votohet në 13 Tetor dhe unë respektoj votën e qytetarëve shqiptarë, nuk kam asnjë shqetësim apo hezitim. Unë edhe deri në 12 tetor do ua përsëris këtë gjë të gjithëve, pasi data është në fuqi", tha Meta. Presidenti Ilir Meta u shpreh gjithashtu se nuk ka frikë nga shkarkimi pas komisionit hetimor që ngriti shumica. "As nga komisioni i Venecias, as nga Bialja e Venecias. Nuk kam hallin e Venecias, por të dalë mbi ujë ky gjyqi i Becchetit, pasi është faturë e madhe shumë".

APELI I METËS

Kreu i shtetit u kërkoi sërish dje aktorëve të politikës nga shumica dhe opozita që të lënë pushimet e gushtit, por të dialogojnë për të gjetur zgjidhjen e krizës. "Kam ndërmarrë iniciativat e mia si President, jo vetëm informale, por edhe publike në mënyrë të hapur dhe të sinqertë, i kam kërkuar edhe OSBE. Unë nuk përkrah politikën e kapjes së institucioneve të Ramës apo axhendën e

Bashës apo zonjës Kryemadhi. Vlerësoj qëndrimet realiste, si partitë opozitare nga Mediu, apo Shehu, apo qëndrimet e z. Milo nga koalicioni i majtë, që kuptojnë që ky proces është i minuar dhe që kërkojnë të hapin kontributin e tyre për ta shpëtuar. Shpresoj që të ketë kontribute të tjera, dhe jo pushime të rehatshme për të rifilluar në shtator me alibitë", tha ai. Meta shtoi se zgjedhje gjithëpërfshirëse nuk ka çelje negociatash. "Pa zgjedhje vendore gjithëpërfshirëse në 13 Tetor, standarde demokratike të besueshme mos prisni asnjë mrekulli të bjerë nga qielli në 18 Tetor dhe të gdhieni në 19 Tetor me çelje të negociatave. Kam apeluar për dialogun politik", tha ai.

BASHA E 'TRADHTOI' PËR SOROSIN, PËRGJIGJIA E METËS

Pak ditë më parë, Shqiptarja.com siguroi një letër ku PD-ja udhëzonte drejtuesit e saj që në debatet televizive por edhe takime me strukturat dhe militantët të mos prekë aspak deklaratat e Metës lidhur me akuzat kundër Soros. Por çfarë mendon Meta për këtë 'tradhti' nga PD-ja? "Unë nuk ndërhyj në asnjë debat të brendshëm. Për çështjen në fjalë, qëndrimi im është publik, i bërë këtu, nuk kam asnjë detyrim ndaj këtij emri që ju përmendët dhe të gjithë fondacioneve apo perandorive të tij, nuk kam përfituar asnjë biletë avioni. Nuk kam asnjë breje ndërgjegje, por edhe po të kisha do ia kisha kthyer për të vijuar mbrojtjen e të drejtave të vendit tim", tha Meta.

"45 minuta" në Report Tv

Artan Hoxha zbulon si do funksionojë njësia speciale kundër të fortëve

Kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar në konferencën e ditës së djeshme se është gati njësia speciale për të luftuar të 'fortët' e rrugëve. Gazetari investigativ Artan Hoxha, i ftuar në studion e "45 minuta" në Report Tv ka zbërthyer të gjithë skemën se si do të funksionojë kjo njësi speciale, në varësi të cilit institucion do të jetë dhe cila do të jetë përbërja e saj. Përballë gazetarit Denis Minga, Hoxha është shprehur se kjo njësi speciale, e cila ende nuk është "pagëzuar" me një emër specifik, do të ketë në përbërje të saj forca komando nga Ushtria, të cilët do të jenë pjesë të operacioneve ku të përfshirë do të jenë edhe me rrezikshmëri të lartë në botën e Krimit. Hoxha është shprehur se këto 30-40 forca komando janë trajnuar në Akademinë e Policisë së Shtetit,



duke kompletuar formimit të tyre ushtarak dhe atë policor. "U zgjodh një trup prej 50 efektivësh nga forcat komando të ushtrisë të cilët u mungon formimi policor janë dërguar në Akademinë e Policisë së Shtetit, ata po e për-

fundojnë trajnimin për mënyrën se si vepron policia, si duhet të veprojnë në operacione. Në fillim janë trajnuar si komando për të luftuar terroristët në fron dhe tani edhe për ato policore. Një nga RENEA është trajnuar për forcat urbane, ai duhet të mbrojë edhe jetën e kriminelit, ndërsa për një komando armiku është i pamëshirshëm. Tani janë 34-40 komando. Kjo njësi do të jetë e varur nga Drejtori i Policisë së Shtetit, por do të jetë autonome. Objektivi kryesor do të jenë arrestimet e shumë të kërkuar që janë problematik dhe goditjen e elementëve të grupeve kriminale me rrezikshmëri shumë të lartë. Kjo njësi do kap ata që Rama i quajti "të fortët e rrugëve". Informacioni kësaj njësi do t'i vijë nga policia kriminale, ata thjesht do e ekzekutojnë", u shpreh Hoxha.



Për Bashën
"Jam 1000% i bindur që zgjedhje të ligjshme janë ato të 13 Tetorit, kush ka dëshirë të regjistrohet, kush ka dëshirë të mos regjistrohet, të dalë me spektatorët".

Ekskluzive
TIRANE

Sizmologu grek: Presidenti juaj është keqinformuar!

Tërmetet, Tselentis: Nuk kam folur kurrë për Ballkanin

Akis Tselentis

"Kurrë nuk kam dhënë ndonjë parashikim, kurrë! Unë vetëm kam folur vetëm për Athinën dhe kam thënë vetëm çfarë mund të ndodh nëse një tërmet magnitudë 6 bie në Athinë".



dy vite. Nuk e di si një gjë e tillë ka dalë se unë kurrë nuk e kam thënë diçka të tillë.

-Ponë fakt i kemi gjetur këto deklarimet tuaja në mediat greke (referuar lajmeve të komenteve të bëra nga Prof. Tselentis për lëkundjet e fundit sismike në Athinë dhe ku NUK përmendet një parashikim apo tërmet i fortë), por presidenti ynë në letër shkruan se tërmeti do të jetë shumë herë më i madh, dhe


ai përdori emrin tuaj lidhur me këtë. Keni një koment?

Presidenti juaj ose është keqkuptuar ose i kanë dhënë informacione të rreme. Një tërmet i magnitudës 6 është 30 herë më i fortë se një tërmet i magnitudës 5 ndërsa ky është 30 herë më i fortë se një tërmet i magnitudës 4. Kjo është thjeshtë matematikë në sizmologji. Ajo që kam thënë unë është kjo! Jo se mund të ndodh një tërmet 30 herë më i

fortë. Athina është zonë sismike dhe tërmete mund të ketë, këtë kam thënë në mediat në Athinë dhe se mund të ketë edhe ndonjë tërmet pak më të fortë por jo se po presim një tërmet të mundshëm. Vetëm të jenë të përgatitur. Nuk kam thënë asnjëherë asgjë për Ballkanin, dhe këto sa më sipër i referoj vetëm për Athinën. Dhe nuk bëra asnjë parashikim por vetëm një indikacion vetëm për Greqinë.

-A janë tërmetet të parashikueshme?

Nuk mendoj se janë, por në disa raste vetëm tërmete me magnitudë me të madhe se 6, mund të japin ndonjë shenjë si rrëshqitje toke, por edhe kjo nuk është e dobishme për parashikim. Dhe për këtë unë flas sërish vetëm për Greqinë, jo Ballkanin. Unë jam profesor



i sizmologjisë, e njoh shumë mirë këtë fushë.

-Keni ndonjë reagim për këtë letër të Presidentit Meta?

Kjo është një letër e rreme, dikush i ka dhënë informacion të pavërtetë presidentit tuaj.

-Kepasur ndonjë kontakt me zyrën e Presidencës shqiptare?

Jo asnjë kontakt. Nuk ka pasur arsye pse të kontaktohem se kjo është Fake News.

Meta insiston: Lajmi për tërmetin apokaliptik është i vërtetë

'Tërmeti apokaliptik', Kryeministri Rama tallet me Presidentin Meta: Ta shtyjë me një dekret!

Presidenti i Republikës Ilir Meta vijon që t'u qëndrojë deklaramëve në letërën që i dërgoi kryeministrit Rama ku paralajmëronte se Shqipëria do të përfshihet nga një tërmet apokaliptik, i cili do të prekë Ballkanin duke cituar sizmologun grek Akis Tselentis. Report Tv pyeti dje Presidentin Ilir Meta gjatë konferencës për mediat se ku u bazua për letërën që i dërgoi kryeministrit Rama duke ngritur alarmin, në kushtet kur sizmologu grek ka deklaruar për Shqiptarja.com se nuk ka bërë një parashikim të tillë. "Unë nuk e di se çfarë ka thënë ky sizmologu grek, këtij janë ato 45 linjet minimale të Greqisë dhe Shqipërisë (tregon listën e mediave), besoj se televizioni ja juaj shquhet për korrektesë dhe profesionalizëm të lartë, besoj se do i japë këto. Këtu janë BBC, të gjitha mediet greke, por edhe ato që ndonjë kolegu jonë i quan kazan, shpresoj mos u përfshijë ju këtu, janë të gjitha këtu. Sikur e tha edhe këshilltari im, Greqia nuk është vend fqinj me Zelandën e Re, por me Shqipërinë. Pak muaj

më parë ndodhi një tërmet, jo i përmendur që është paralajmëruar sipas medieve nga drejtori në fjalë në Greqi dhe e dini sa e vështirë ishte për të menaxhuar pasojat, po i patët harruar shkoni dhe pyesni banorët dhe fëmijët që u plevitosën atje në ato çadra. Unë nuk kam letër për mediat, por institucionale për qeverinë në zbatim të detyrimeve të tyre ligjore, por ishte më e lehtë të

shpërndahej te ju. Besoj se do ta botoni edhe ju me profesionalizimin që ju karakterizon", tha Meta. Ndërkohë që më herët ishte Këshilltari i Presidentit të Republikës për Çështjet e Sigurisë Kombëtare Bahri Shaqiri që në një konferencë për mediat u shpreh se letra u dërgua pas shqetësimit të sizmologut grek Akis Tselentis dhe pasqyrimin sipas tij në mediat kombëtare

dhe ndërkombëtare. "Presidenti iu drejtua dje me një kërkesë për informacion Ramës, Braçes dhe ministres së Mbrojtjes mbi kapacitet dhe masat për parandalimin e fatkeqësive natyrore. Kërkesa ishte për parandalimin e pasojave të mundshme për qytetarët. Pas shqetësimit të drejtorit të Institutit Gjeodinamik të Athinës për tërmet për riskun potencial për një fatkeqësi naty-



Meta

"Greqia nuk është vend fqinj me Zelandën e Re, por me Shqipërinë. Pak muaj më parë ndodhi një tërmet, jo i përmendur që është paralajmëruar sipas medieve nga drejtori në fjalë në Greqi".

rore në mediat ndërkombëtare. Kryeministri dhe ministrat duhet të përgjigjen. Çdo nënvlerësim do të shënohet me vëmendje nga Presidenti. Ne do i vendosim në dispozicion një listë me mediat kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë shkruar për këtë gjë", tha ai.

RAMA TALLET ME METËN

I pyetur nga Report Tv nëse është i gatshëm për të rregulluar marrëdhëniet Presidentin Ilir Meta pas luftës institucionale të muajve të fundit, kryeministri Rama u përgjigj duke thënë se është gati ta ndihmojë kreun e shtetit nëse ia kërkon. "Jo nuk e kam në plan, por jam gati ta ndihmoj Presidentin nëse ma kërkon, pasi jam shumë i keqardhur për Presidentin dhe gjendjen e institucionit. Do të vijoj që të kursehem sepse realisht situata e presidentit është e rëndë dhe nuk dua t'i shkoj më shumë vështirësi në perceptimin e realitetit", tha ai. Një koment kishte edhe për letërën që Meta i dërgoi për 'tërmetin apokaliptik'. "Tërmetin e ka shumë të thjeshtë, të nxjerrë një dekret dhe e shtynë" tha Rama me ironi. Por a është takuar kreu i qeverisë me kreun e shtetit në javët e fundit pas zgjedhjeve? "Jo faleminderit", e mbylli Rama.



NJOFTIM

Shoqëria Përmbartimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k., me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-2, të pasurive të paluajtshme në pronësi të z.Et'hem Xhelaj dhe znj.Zilo Xhelaj, lënë garanci për "OTP Bank" sh.a

-NË DATË 15.08.2019 ORA 16:00.

"Ndertese" Pasuri nr. 54/49-ND, Vol.21, Fq.57, ZK.8605, me sip.20 m² me adrese lagja "28 Nentori", Vlore, ne pronesi te z.Et'hem Xhelaj dhe znj.Zilo Xhelaj, me çmimin fillestar 1,523,200 leke.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com



NJOFTIM

Shoqëria Përmbartimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k., me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-2, të pasurive të paluajtshme në pronësi të shoqërisë "Alumix" sh.p.k me pale kreditore "Alpha Bank" sh.a

-Në datë 09.08.2019 ora 16:00.

"Apartament" Pasuri nr. 8/483+2-22, Vol.22, Fq.232, ZK.8120, me sip.112.7 m² me adrese Rr. "5 Maji", Korpusi B, Ap.22, Tiranë, ne pronesi te shoqërisë "Alumix" sh.p.k, me çmimin fillestar 42,560 Euro.
"Apartament" Pasuri nr. 8/483+1-11, Vol.22, Fq.179, ZK.8120, me sip.68.6 m² me adrese Rr. "5 Maji", Korpusi B, Ap.11, Tiranë, ne pronesi te shoqërisë "Alumix" sh.p.k, me çmimin fillestar 26,600 Euro.
"Garazh" Pasuri nr. 8/483-G3, Vol.22, Fq.180, ZK.8120, me sip.160 m² me adrese Rr. "5 Maji", Korpusi B, Garazh nr.3, Tiranë, ne pronesi te shoqërisë "Alumix" sh.p.k, me çmimin fillestar 34,832 Euro.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com

Erion Veliaj u betua këtë pasdite për një mandat të dytë si kryetar i Bashkisë së Tiranës për të vijuar punën për transformimin e Tiranës në qytet modern evropian dhe bashkëkohor, siç ai u shpreh. Tirana ka një Këshill Bashkiak të ri. 61 këshilltarët e zgjedhur në 30 qershor janë betuar dhe duke konstituuar edhe “parlamentin” e ri të qytetit, ndërsa kryetar i tij u zgjodh zëvendësministri i Drejtësisë, Toni Gogu. Në detyrën e nënkryetarëve të Këshillit u zgjodhën Vjollca Braho dhe Luan Bregasi. Ndërsa në detyrën e nënkryetarëve të bashkisë u zgjodhën Anisa Ruseti dhe Anuela Ristani.

Kryeministri Edi Rama i pranishëm në ceremoninë e betimit ka vlerësuar punën e kryebashkiakut Erion Veliaj në krye të Bashkisë së Tiranës për katër vitet e para. Në fjalën përshëndetëse në ceremoninë e betimit të kryebashkiakut Veliaj, Rama tha se krahasimi me si u gjet Bashkia e Tiranës dhe qyteti dhe si është sot, “është vrasar për ata që e lanë qytetin në derexhe për katër vite më parë”.

ERION VELIAJ

Pas betimit si kryetar i Bashkisë së Tiranës edhe për një mandate të dytë, Erion Veliaj shprehu angazhimin se nuk do t'i zhgënjë qytetarët dhe se do të punojë për vijimin e projekteve transformuese për qytetin. Në fjalën e mbajtur në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, Veliaj u betua se do të bëjë më të mirën për Tiranën e shekullit të ri. “Mezi pres të filloj punën dhe ta bëjmë këtë qytet ëndërr për fëmijët tanë. Është bekimi më i madh në jetën e njeriut, të drejtosh dhe të jesh në shërbim të njerëzve”, tha Veliaj. “Kam rënë në dashuri me Bashkinë, nostalgjia e një vendi që ke kaluar me përkushtim ditë të tëra, sot jam dyfish i nderuar për besimin që mu dha nga PS dhe nga qytetarët e Tiranës, dhe e kuptoj edhe Edi Ramën kur ma ka dhënë detyrën se sa të vështirë e ka pasur. Unë besoj që arritja më e madhe është njerzillëku, fakti që këtij qyteti i shërbejmë në një mënyrë që rrogat në shtet nuk janë të atij niveli që i shohim në privat, por bashkia shihet si mision ndaj qytetarit. Kjo më bën të ndihem i përkulur dhe shumë krenar për stafin e Bashkisë së Tiranës”, theksoi më tej kryebashkiaku.

Në fjalën e tij, Veliaj renditi disa nga projektet që do të bëjë në këtë mandat të dytë, duke nisur që nga zona e lirë ekonomike që do i japë një impuls të ri ekonomisë tek nisja e punës për Kampusin e Ri Universitar. “Dua që grupi që do të punojë për urbanistikën, menjëherë t'i bashkohet zv/ kryetarit, për të lehtësuar të gjithë procedurat për Kampusin e Ri Universitar. E përmendi kryeministri, jemi bashkë sërish, për të mbajtur



PROJEKTET

Rama: Ja çfarë do të bëjmë me Veliajn në 4 vitet e ardhshme

Kryeministri Edi Rama ka treguar se diskuton vazhdimisht me Kryetarin e Bashkisë Erion Veliaj në lidhje me projektet për transformimin e qytetit. Në fjalën e tij përshëndetëse në Këshillin Bashkiak, Rama rikonfirmoi vullnetin e përbashkët të qeverisë dhe të bashkisë për një sërë projektesh të rëndësishme infrastrukturore. “Piramida që do hapet, kampusi I ri universitar që do ndërtohet brenda këtij mandati të sapo nisur sot, teatri tjetër kombëtar për fëmijët pas këtij për të rriturit, kopshti I ri zoologjik, unaza e madhe ajo që shtrihet përtej unazës së re dhe lidhet me Bregun e Lumit, parku olimpiq që duhet të plotësohet sheshi Nënë Tereza që do të këmbësohet dhe ndërtesa e re e akademisë së arteve. Nuk do shembim këtë që është, por pjesa plotësuese që asaj I ka ardhur fundi u ndërtua në komunizëm por nuk është më. Biblioteka kombëtare, rrjeti i ri i agroturizmit përreth”, tha Rama.

Betohet Erion Veliaj: Kam rënë në dashuri me Bashkinë!

Konstituohet Këshilli i ri Bashkiak, Tonin Gogu zgjidhet kryetar. Kryeministri Rama: Mos harroni si e gjetëm Tiranën në kohën e Bashës



Batuta

Veliaj për Ramën e Tonin Gogun: Kemi dy katunarë këtu

Erion Veliaj e shoqëroi me batuta ceremoninë e betimit si kryebashkiak në mandatin e tij të dytë në Tiranë. Toni Gogu, kryetari i ri i këshillit bashkiak të Tiranës është nga Peza, ndërsa i pranishëm në ceremoni ishte dhe kryeministri Edi Rama. Veliaj i quajti të dy katunarë, nisur nga fakti që kryeministri Edi Rama jeton në periferi të Tiranës, në Surrel dhe tha se Bashkia do të kthejë edhe më shumë sytë nga fshati me investime. “Një katunar nga Peza, Toni Gogu...Kemi dy katunar këtu tani që (Rama) është transferuar atje dhe na sjell përditë lajme nga fshati. Duhet të përmirësojmë vendimarrjen ndaj fshatit, përfaqësimin 50 me 50 të vajzave dhe grave. Kemi një përfaqësim dinjitoz nga fshati, dhe disa nisma konkrete përtej gjelave të baldushkut: Tregu publik i shumicës në Farkë!”, tha Veliaj. Ai falenderoi kryeministrin Edi Rama edhe për traditën e re të bashkëpunimit dhe komunikimit me biznesin.

Kemi vënë pllakën e parë me kryeministrin në fillim të këtij mandati dhe jam i lumtur që më fund e pamë të përfundojë kjo shtyllë e re kurrizore e Tiranës që zgjat dy herë gjatësinë e qytetit dhe të shikojmë se si ajo që quhet zona Fin Tech, të vazhdojë e të zhvillohet në zonën e bulevardit të ri ku besoj të gjithë do jemi krenarë dhe kur t'i lëmë këto poste, për të thënë që nisëm një shekull të ri për Tiranën tonë”, deklaroi kryebashkiaku Veliaj i cili nga sot nis mandatin e dytë në krye të Tiranës duke e udhëhequr drejt të katër vjeçari të ri transformues.

EDI RAMA

Kryeministri Edi Rama ka vlerësuar punën e kryebashkiakut Erion Veliaj në krye të Bashkisë së Tiranës për

katër vitet e para. Në fjalën përshëndetëse në ceremoninë e betimit të kryebashkiakut Veliaj, Rama tha se krahasimi me si u gjet Bashkia e Tiranës dhe qyteti dhe si është sot, “është vrasar për ata që e lanë qytetin në derexhe për katër vite më parë”. “Bilanci i derikëtushëm i Bashkisë është padiskutim pozitiv, por padiskutim nevojat janë shumë dhe pritshmëritë. Edhe pse koha ka shkuar, është e nevojshme të mos harrojmë se nga u nisëm katër vite më parë. Krahasimi me si e gjetëm dhe si e kemi Tiranën, është vrasar për ata që e lanë Tiranën në derexhe katër vite më parë. Arsyeja është duke bërë këtë krahasim në vijimësisht marrim kreditet e nevojshme të besimit të njerëzve për të bërë shumë më shumë”, tha Rama.

premtimin e kryeministrin me studentët. Kemi rinovuar shumicën e godinave në Qytetin Studenti, na kanë ngelur edhe tre të fundit, megjithatë komisioni I Urbanistikës që do të punojë për gjithë çështjet e Kampusit të Ri Univeristar do të duhet që ta adresojë këtë

që një mbledhjen e parë për të ecur përpara”, tha Veliaj. Teksa theksoi se Tirana është në pesëshen finale për të qenë kryeqyteti evropian i Rinisë në 2022, Veliaj shprehu ambicien për të ndërruar më shumë shkolla, kopshte, çerdhe. Por një nga xhevahirët e Tiranës

është Bulevardi I ri ku po projektohet Tirana e 100 viteve të ardhshme. “Nëse në 100 vitet e fundit Tirana është rritur përtej një shtylle kurrizore që quhet bulevardi i vjetër, parashikojmë që në 100 vitet e ardhshme Tirana të rritet tek ai që quhet bulevardi I ri.

Mziu dhe Voltana Ademi 1 vit burg nëse nuk lëshojnë zyrat

Ja pasoja penale për kryebashkiakët e PD-LSI që kryejnë funksione pas betimit të të zgjedhurve të rinj



NENI 249 I KODIT PENAL

Vazhdimi i ushtrimit të funksionit shtetëror apo të shërbimit publik nga ana e personit që është vënë në dijeni të vendimit apo rrethanës që u ka dhënë fund ushtrimit të tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Mziu-Ademi

Më të vendosur për rezistencë janë shfaqur kryebashkiaku i Kamzës Xhelal Mziu dhe kryebashkiakja e Shkodrës Voltana Ademi, sipas të cilëve vijimi i tyre në detyrë u konfirmuar në zgjedhjet e 30 qershorit.



se parë, të cilat kanë njohur deri më tani mandatet për të gjithë kryebashkiakët e rinj. Gjithashtu, zgjedhjet e 30 qershorit janë njohur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian.

BASHA NXIT TË VETËT PËR REZISTENCË

Kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha është ndalur dje në Devoll ku ka thënë se kjo bashki është uzurpuar nga ajo që ai e quan banda kriminale e Partisë Social-

iste. Në mbështetje të Bashës kanë shkuar edhe një grup militantësh që e mbështesin duke kërkuar që bashkia të lirohet nga kryetari i ri Eduard Duro. "Kam kënaqësinë të ndodhem në këtë manifestim të madh të demokracisë dhe vendosmërisë për të mos pranuar vjedhjen dhe uzurpimin e pushtetit vendor nga një bandë që është në pushtet. Pakica kriminale ka uzurpuar bashkinë e Devollit, shumë shpejtë do ta shporrim këtë pakicë nga Devoli dhe nga Shqipëria. Hajduteskë...me pushtimin e bashkisë si hajdutë me pushtimin e pushtetit vendor si kriminel dhe me tentativën për të vendosur mbi 94% të qytetarëve të Devollit. Rama dhe soziteti i tij kanë shkruar fatin e tyre në Devoll dhe në mbar vendit. Fati i tyre është ai që pret çdo hajdut. Shporrja me çdo kusht me çdo mjet me çdo formë. Kjo është dhunë antikushtetuese kriminale dhe antiligjore. Keqardhje për përdorimin e policëve duhet të arrestonin hajdutin. Hajdutët i kanë bërë

Pasojat

Sipas Kodit Penal kryerja e funksioneve nga kryebashkiakët pas mbarimit të mandatit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.



llogaritë në ditët e fundit të korrikut. Kanë kujtuar se me vapën e verës do të realizojnë vjedhjen. Nuk do të qeverisin dot asnjë ditë. Sot në Devoll, Kavajë Pogradec, Kamëz e në të gjithë Shqipërinë... Do të përballen me vendosmërinë tonë", ka deklaruar Basha.

ADRIATIK DOÇI TIRANE

Pas dështimit për të bllokuar zgjedhjet e 30 qershorit, sikundër përbetohej disa herë në ditë, Partia Demokratike me në krye Lulzim Bashën ka nisur një aksion të ri politik, tashmë duke mbajtur me forcë zyrat e kryebashkiakëve si dhe duke bllokuar të zgjedhuri e rinj, për të ushtruar detyrën. Në disa takime me kryebashkiakët demokratë, Basha u ka kërkuar atyre të mos lëshojnë zyrat si kryetar të bashkive, me pretendimin se zgjedhjet e 30 qershorit janë të ligjshme. Më të vendosur për rezistencë

janë shfaqur kryebashkiaku i Kamzës Xhelal Mziu dhe kryebashkiakja e Shkodrës Voltana Ademi, sipas të cilëve vijimi i tyre në detyrë u konfirmuar në zgjedhjet e 30 qershorit, ku, gjithnjë sipas tyre, 85 %, nuk morën pjesë, votues të cilët PD i konsideron mbështetës të saj. Por, nëse Partia Demokratike do t'i shkojë deri në fund këtij skenari, kryebashkiakët e saj, do të përballen pasojat penale. Kryerja e funksioneve nga kryebashkiakët pas mbarimit të mandatit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Neni 249 i Kodit Penal parashikon që vazhdimi i ushtrimit të funksionit shtetëror apo të shërbimit publik nga ana e personit që

është vënë në dijeni të vendimit apo rrethanës që u ka dhënë fund ushtrimit të tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Pra, çdo akt i përfaqësuesve të PD-LSI pas betimit të kryebashkiakëve të rinj jo vetëm është nul, por përbën edhe vepër penale. Përfaqësuesit e PD pretendojnë se zgjedhjet e 30 qershorit nuk janë të vlefshme dhe se zgjedhjet e ligjshme janë sipas tyre në 13 tetor, ndonëse Lulzim Basha nuk është deklaruar ende qartë nëse e njeh apo jo dekreten e fundit të Presidentit. Por, zgjedhjet janë certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor dhe gjykatat e shkallët

Betohen kryebashkiakët e Korçës, Divjakës e Tepelenës

Ditën e djeshme përveç kryetarit të ri të Kavajës, janë betuar edhe kryetarët e bashkisë Divjakë, Tepelenë e Korçë. Sotiraq Filo është betuar si kryebashkiaku i ri i bashkisë së Korçës, po kështu në bashkinë e Korçës janë Korçës janë konstituuar edhe Këshilltarët Bashkiak. Në krye të Këshillit Bashkiak Korçë me shumicë votash është zgjedhur Erjon Nexhipi. Gjithsej nga 41 këshilltarë: 33 PS; 1 PSD; 1 PDS; 2 PGJ; 1 BD; 1 Fryma e re Demokratike; 1 PS e moderuar; 1 Partia Alenca Arbnore Kombëtare. Në bashkinë e Divjakës është betuar kryetari i ri i dalë nga zgjedhjet e 30 qershorit, Fredi Kokoneshi. Në Divjakë situata gjatë betimit të Kokoneshit ishte

tepër e qetë dhe nuk kishte asnjë militant të PD për të kundërshtuar apo protestuar. Në betimin e kryebashkiakut të ri të bashkisë Divjakë, Fredi Kokoneshi ka qenë i pranishëm edhe zv/kryeministri Erion Braçe. Po kështu në këtë bashki janë konstituuar edhe Këshilli Bashkiak. "Jam në fillim të mandatit të 4 është shumë i rëndësishëm për mua. Po mendoj të zhvilloj qytetin tim. Nuk është fort e mirë që zgjedhjet ishin pa garë. Do të doja që zgjedhjet të ishin me garë. Është zgjedhja e tyre. Nuk kam patur kundërshtim. Është një detyrë shumë e rëndësishme dhe fisnike. Ne së bashku kemi bërë një punë shumë të mirë. Por do jemi drejt përmirësimit. Është një

përgjegjësi sepse ka të bëjë me qytetarët. Prioritet do të jetë zhvillimi urban i çdo fshati dhe zhvillimi ekonomik i qytetarëve", ka deklaruar në një dalje për mediat Kokoneshi. Ndërsa Braçe ka deklaruar: "Siç e shihni është një proces normal që po vijon. Dua ta nis nga Divjaka kemi një përmirësim cilësor. Në këshillin bashkiak janë 13 gra dhe vajza. Të gjitha profesionet janë në përbërje të këshillit. Ka përfaqësime të të gjitha njësive vendore. Unë do doja që kështu të vazhdonte në të gjithë territorin e vendit. Do të doja që të respektohet vota e 30 qershorit. Do të doja Do Doja ti bëja një thirrje të gjithë kryetarët e bash që ju ka mbaru mandat që të

dorëzojnë detyrën në qetësi në mënyrë paqësore me mënyrë të kulturuar dhe të dorëzojnë të gjithë bazën administrative me qëllim që puna të vazhdojë menjëherë në shërbim të qytetarëve. Nuk do të doja të krijohej vakum. Tashmë pas përfundimit të mandatit është i dëmshëm dhe ju bëj thirrje që mos të krijojnë vakum". Edhe në Bashkinë e Tepelenës është betuar kryetari Tërmet Peçi. Para betimit të Peçit është konstituuar Këshilli Bashkiak i Tepelenës. Të pranishëm në procesin e konstituimit të këshillit ishin deputetët e qarkut Bledi Çuçi dhe Mirela Kumbaro, si dhe prefekti Astrit Aliaj. Po ashtu edhe në Memaliaj, Gjolekë Guci




ka marrë detyrën. Pak minuta para betimit gazetari i Report TV ka pasur një incident me kryetarin, teksa po merrte pamje të vendosjes së shiritit. Ndërkohë brenda 2 javëve të gushtit do të behet konstituimi i këshillave të ri bashkiak dhe betimi i kryetareve të bashkive Kukës Has dhe Tropojë. Prefekti i Qarkut Kukës Z.

Zenela Kuçana bën të ditur se ky proces do të bëhet me 2 Gusht në Kukës, me 5 Gusht në Has dhe me 13 Gusht në Tropojë. Kuçana thotë se janë marrë të gjitha masat për zhvillimin e këtij procesi. Ndërkohë ende nuk dihet si do veprojnë 2 bashkitë e djathta për dorëzimin e pushtetit vendor.

Kryebashkiaku i PS hyn në Bashkinë e Kavajës, dera hapet nga policia

Shuhet rezistenca e PD në Kavajë, opozitari i dorëzon me 'page' detyrën kryebashkiakut të ri të Rrogozhinës



Redjan Krali

Është betuar dje kryetari i ri i Bashkisë Kavajë, Redjan Krali, ndërsa disa orë më pas, me ndihmën e policisë, ka hyrë në zyrë. Rezistenca e Partisë Demokratike ka zgjatur deri pasdite.



Jahollari

Prefektja e Tiranës Suzana Jahollari deklaroi se ish-kryetari i bashkisë së Rrogozhinës Beqir Nuredini i zgjedhur i përfaqësues i PDIU-së katër vite më parë dorëzoi detyrën në mënyrë procedurale.

Është betuar dje kryetari i ri i Bashkisë Kavajë, Redjan Krali, ndërsa disa orë më pas, me ndihmën e policisë, ka hyrë në zyrë. Kryetari në detyrë i zgjedhur nga PD-ja, Isa Sakja u shpreh paraditen e djeshme se nuk do ta lirojë zyrën, ndërsa jashtë godinës u mbledhën mbështetës të opozitës. Sakja ka dhënë një prononcim të shkurtër për mediat duke u shprehur se “sot do të jem në detyrë. Vazhdoj detyrën, nuk mund të lë bashkinë kur vetëm 5 për qind e qytetarëve të Kavajës kanë votuar”. Ndërkohë pas betimit të Kralit, i cili është nipi i Fatos Nanos, një grup militantësh të PD janë grumbulluar para bashkisë dhe kanë sulmuar policinë si dhe Perfekten e qarkut të Tiranës, Suzana Jahollari, e cila po mbante një konferencë për shtyp ku po sqaronte procedurat ligjore për konstituimin e Këshillit Bashkiak. Militantët e PD u shprehën të vendosur për të mos lejuar që kryetari i ri i bashkisë së Kavajës, i cili sapo u betuar, Redjan Krali që të hyjë brenda ambienteve të bashkisë. Ndërkohë në një deklaratë për mediat kreu i Policisë së Kavajës ka deklaruar se ai është aty së bashku me policinë për të siguruar kalimin e detyrës tek kryebashkiaku i ri Krali. Pas acarimit të situatës policia është tërhequr për të mos krijuar agravimin e mëtejshëm të agresivitetit të ushtruar nga militantët e PD. Megjithatë, policia është kthyer sërish dhe rezistenca e PD ka zgjatuar deri pasdite. Dera e Bashkisë Kavajë u hap nga policia. Ish-kryebashkiaku, Isa Sakja u largua nga zyra, ndërsa dera e bashkisë u mbyll nga zyrtarët e PD-së. Disa orë më pas, policia hapi derën e bashkisë dhe kryetari i ri i Bashkisë Kavajë, Redjan Krali, hyri në zyrë, duke nisur zyrtarisht detyrën. Ky skenar është i ngjashëm me atë që ka ndodhur edhe në Bashkinë e Devollit. Ndërkaq, koordinatoreja e PS për qarkun e Tiranës, Elisa Spiropali e pranishme në Kavajë, ka deklaruar pas betimit të kryebashkiakut të Ri, Redjan Krali se askush nuk do të mund të pengojë punën e PS dhe të kryetarëve të rinj. Sipas Spiropalit puna në Kavajë do të nisi ditën e nesërme. “Do nisim punën që nesër. Nuk i pengon dot asnjë huligan dhe asnjë çetë. Organet ligjzbatuese të bëjnë punën e tyre”, ka deklaruar Spiropali.

KRYEBASHKIAKU SOCIALIST I KAVAJËS: S'MË DUHET NJË ZYRË

Me thirrjet “fitore”, kryebashkiaku socialist i dalë nga zgjedhjet e 30 qershorit, Redjan Krali ka dalë përpara mediave, pasi hyri për herë të parë në Bashkinë e Kavajës si kreu i saj. Ai deklaroi se puna në Bashki ka filluar që në momentin që ai po jep këtë deklaratë. I pyetur se çfarë do të ndodhë nëse nesër do të gjejë në zyrë ish-kreun e Bashkisë, Isa Sakja, Krali tha se ai e ka derën e hapur, për tani e tutje vetëm si qytetar. “Nga ky moment fillon puna e bashkisë. Kryebashkiaku i vjetër nuk ka

të drejtë ligjore, derën e ka të hapur, por si qytetar. Mua sot më duhet zyra, nesër më duhet terreni se unë do të jem në punë. Çfarë do ndodhë nëse Isa Sakja do të vijë nesër në zyrë? Ligji flet, kam vendim gjykatë”, u shpreh Krali.

KRYEBASHKIAKU I RROGOZHINËS

Konstituohet Këshilli Bashkiak i Rrogozhinës dhe për herë të parë ndodhi që një kryetar bashkie i zgjedhur nga radhët e opozitës i dorëzoi detyrën të zgjedhurit të ri në 30 Qershor nga radhët e socialistëve. Pas 21 anëtarëve të rinj të këshillit bashkiak, teksa 20 i përkasin Aleancës për Shqipërinë Evropiane dhe një është i Demokracisë Sociale u betua kryetari i ri i bashkisë, Haxhi Memolla, ndërsa ish-kryetari Beqir Nuredini i dorëzoi detyrën. Prefektja e Tiranës Suzana Jahollari përshëndeti këtë veprim. “Falënderoj Beqir Nuredinin për dorëzimin e detyrës në mënyrë

procedurale. Të njëjtën gjë do të doja edhe për Isa Sakjen për të dhënë shembullin se dimë të veprojmë si qytetar”, tha ajo. Beqir Nuredini nuk pranoi të hynte në zgjedhjet e 30 qershorit, pasi i zgjedhur katër vite më parë si pjesë e PDIU-së, respektoi vendimin e opozitës për bojkot. Kjo është hera e parë kur një i zgjedhur nga radhët e partive që tashmë janë në opozitë ka dorëzuar detyrën, pasi në Devoll, Kavajë, por edhe bashkitë e tjera që drejtohen nga përfaqësues të PD-së apo LSI-së ka rezistencë. Të pranishëm ishin edhe Arben Ahmetaj dhe Elisa Spiropali, e cila së bashku me Ervin Bushatin drejton qarkun e Tiranës. Rrogozhina ishte një prej bashkive ku Partia Socialiste nuk pati kundërshtarë përballë më 30 qershor, ndërsa tashmë nga PDIU-ja kalon në drejtimin e PS-së. Sot pritet që të konstituohen edhe këshillat bashkiakë të Tiranës dhe të Kavajës.

VENDIMI

Apeli rrëzon gjykatën e shkallës së parë për kryebashkiaken e Durrësit

Apeli ka rrëzuar vendimin e gjykatës së Shkallës së Parë duke pushuar kështu çështjen kundrejt kryetares së re të Durrësit të dalë nga zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Kujtojmë se vendimi i shkallës së Parë dhënë nga gjyqtarja Margjeka, e konsideronte procesin zgjedhor nul pasi sipas saj Bindja Demokratike ishte regjistruar me vonesë. Ka qenë vetë Sako ajo që e apeloj vendimin e Margjekës. Në këtë mënyrë apeli zgjidhi këtë çështje e cila krijonte përshtypjen e një nonsensu juridik. Ndërsa gjyqtari i Apelit, Arjan Balliu relatori i kësaj çështjes së bashku me 2 gjyqtarë të tjerë rrëzuan vendimin e Margjekës. Pas shpalljes

fillimisht si nul të procesit zgjedhor të 30 qershorit, herën e dytë, kërkesa për njohjen e mandatit të Sakos u bë nga Partia Socialiste dhe ishte firmosur nga kryeministri Edi Rama. Në këto kushte mbetet në fuqi vendimi i gjyqtarit të shkallës së parë Shpëtim Reka i cili me kërkesë të kryetarit të PS Edi Rama vërtetoi mandatin e Sakos. Meqenëse vendimi i Rekës ishte i formës së prerë nuk shqyrtohet nga Apeli dhe ka hyrë menjëherë në fuqi. Në këtë mënyrë gjykata e Apelit duke shfuqizuar vendimin e Margjekës ka lënë në fuqi vetëm një vendim të gjykatës së shkallës së parë për vërtetimin e mandatit të Sakos.



NISMA

Shkarkimi i Metës, Komisioni i Venecias fut në axhendë çështjen

Vetëm disa ditë pasi Kuvendi i Shqipërisë i dërgoi letër lidhur me procedurat për shkarkimin e presidentit të Republikës, Komisioni i Venecias e ka vendosur në axhendë shqyrtimin e letrës. Duket se ky komision kërkon të mos humbasë më kohë për të shqyrtuar këtë çështje. Në letrën e firmosur nga kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi i kërkon Komisionit të Venecias që të sjellë sa më shpejt që të jetë e mundur opinionin mbi nismën për të shkarkuar presidentin e Republikës nisur nga ndjeshmëria e çështjes në vendin tonë.

Pritet që Komisioni i Venecias të sjellë opinionin mbi këtë çështje në muajin shtator. Për Komisionin e Venecias janë hartuar 8 pyetje të cilat kërkojnë përgjigje sa i përket vendimit të presidentit Meta. Pyetjet konstatojnë të kompetencat e presidentit për të zhdukur një datë zgjedhje, të cënimi i parimeve të së drejtës së qytetarëve për të dhënë votën e tyre dhe cënimi i sigurisë juridike. Kërkesa nuk ishte surprizë, pasi u vendos në datë 15 korrik nga Komisioni Hetimor që të kërkohej dhe mendimi i ndërkombëtarëve.

Kritiku i Bashës:

“Marrëveshja e PD-së me artistët, budallallëk!”



Ish kreu i PD-së së Kukësit, Ihsen Elezi, i njohur për qëndrimin kritik ndaj strategjisë së drejtimit të partisë nga Lulzim Basha, e ka cilësuar si budallallëk nënshkrimin e marrëveshjes së PD-së me artistët kundër shembjes së Teatrit Kombëtar. I ftuar në studion e Report Tv, Elezi argumentoi se ky qëndrim vjen duke iu referuar të kaluar, duke thënë se opozita ka dështuar në këto nisma. Ai solli si shembull deklaratën e përfaqësuesve të PD-së se do të pengojnë me trupat e tyre që të vendoset traut në rrugën e Kukësit, gjë që nuk ndodhi. “Marrëveshja e PD-së me aktorët, budallallëk. Opozita duhet ta ketë në vullnetin e tij politik. Na tha dhe ne kukësiatëve nuk do lejojmë traun me trupat tanë dhe na bëri bisht. Opozita i dështon këto nisma, po në Tiranë nuk do e ketë të lehtë. Pas traut kjo do të jetë përplasja e dytë që Rama dhe qeveria do të dorëzohet”, tha Elezi në Report TV.

Departamenti i Shtetit ndalon hyrjen në Shtetet e Bashkuara të Kryetarit të Bashkisë së Durrësit Vangjush Dako dhe familjes së tij. Në vendimin e marrë nga Sekretari i Shtetit argumentohet se kryetari i bashkisë Dako është përfshirë në raste madhore korrupsioni. Në bazë të ligjeve amerikane, kur Sekretari i Shtetit, ka informacione të besueshme se një zyrtar i huaj është përfshirë në raste madhore korrupsioni, ose shkelje të të drejtave të njeriut, atij dhe familjes së tij të ngushtë i ndalohet hyrja në Amerikë.

Ligji po ashtu i jep të drejtë Sekretarit të Shtetit që vendimin ta bëjë publik, ose t'ia bëjë atë privatisht zyrtarit në fjalë. Në bazë të njoftimit të djeshëm, Vangjush Dako, bashkëshortja e tij Alba Dako, djali Xhulio Dako dhe vajza e tij Kejsi Dako nuk lejohen të hyjnë në Amerikë. Vendimi i djeshëm, thuhet në njoftimin e Departamentit të Shtetit, është një sinjal i fortë se Shtetet e Bashkuara janë të angazhuara për të luftuar korrupsionin në vende të tjera të botës. Dako, bëhet kështu zyrtari i tretë nga Shqipëria së bashku me Adriatik Llallën dhe Tom Doshin që ndalohen të hyjnë në Shtetet e Bashkuara.

Kryebashkiaku në detyrë i Durrësit Vangjush Dako i pyetur për Report Tv u shpreh se nuk ka asnjë koment për vendimin e SHBA-së që i ndaloj hyrjen. "S'kam asnjë koment" kështu u shpreh



Hesht Dako

Kryebashkiaku në detyrë i Durrësit Vangjush Dako i pyetur për Report Tv u shpreh se nuk ka asnjë koment për vendimin e SHBA-së që i ndaloj hyrjen. "S'kam asnjë koment" kështu u shpreh Vangjush Dako në një lidhje telefonike për Report Tv

Vangjush Dakos dhe familjes së tij i ndalohet hyrja në SHBA

Departamenti i Shtetit: Eshtë përfshirë në raste madhore korrupsioni. Basha: Një lajm i mirë dhe i keq njëkohësisht

Vangjush Dako në një lidhje telefonike për Report Tv.

BASHA: NJË LAJM I MIRË DHE I KEQ NJËKOHËSISHT

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha e ka cilësuar si një lajm të mirë refuzimin e vizës nga SHBA të ish-kryebashkiakut të Durrësit Vangjush Dako. Sipas tij, ky është një lajm i mirë, pasi jo vetëm është i korruptuar, por edhe pjesë të krimit të organizuar, teksa thekson se ka dhe një "lajm të

keq" në këtë histori. Basha shprehet se pavarësisht këtij vendimi të SHBA, që shërben si një konfirmim ta akuzave të PD-së, lajm i keq është se ai nuk ka dalë akoma para drejtësisë për asnjë rast korrupsioni. "Është lajm i mirë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë shpallur non grata Vangjush Dakon për "përfshirje në raste të mëdha korrupsioni." Është lajm i keq që Vangjush Dako nuk ka dalë akoma para drejtësisë për asnjë rast korrupsioni.

Vangjush Dako nuk është vetëm një politikan i korruptuar. Ai është pjesë e krimit të organizuar, në bashkëpunim me të cilin vodhi zgjedhjet për llogari të pushtetit të Edi Ramës. Si shpërblim, Vangjush Dako i dorëzoi krimit të organizuar kontrollin ekonomik dhe politik të Bashkisë së Durrësit. Është lajm i keq që Vangjush Dako ka si mburojë paprekshmëri nga drejtësia kryeministrin e vendit, Edi Rama. Veprat e mëdha të korrupsionit janë bërë

nën mbrojtjen, me dijeninë dhe për përfitimin e Edi Ramës. Është Edi Rama ai që e mbron Vangjush Dakon apo siç e quajnë miqtë e tij, bankmatin personal të parave të pista të Edi Ramës. Përpara ligjit dhe Kushtetutës, Edi Rama zgjodhi gjithmonë Dakon, edhe kur gazeta gjermane BILD tregoi bashkëpunimin direkt me krimin e organizuar për të blerë zgjedhjet në 2017. Edi Rama i mbron kriminelët e tij, brenda dhe jashtë politikës, sepse

ai e ka të qartë se as nuk e merr dhe as nuk e mban dot pushtetin pa krimin.

Në fund, ai nuk nguroi që të akuzonte kryeministrin Edi Rama si fajtor kryesor duke theksuar se largimi i tij është i domosdoshëm. "Prandaj, largimi i Edi Ramës është zgjidhja për të shpëputur lidhjet e politikës me krimin, për të vënë qeverinë në interes të qytetarëve, jo të krimit dhe të oligarkëve me të cilët vjedh çdo ditë shqiptarët", shprehet Basha.

KANDIDAT PËR SPAK

Altin Dumani në 'sitën' e Vetting-ut, vëzhguesi ndërkombëtar asnjë pyetje

Theo Jacobs vëzhgues i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në procesin e

Vetting-ut ditën e sotme për 'çudi' nuk ka bërë asnjë pyetje në seancën e prokurorit Altin

Dumani. Jacobs në seancat e mëparshme ka qëndruar me 'dorë të hekurt' ndaj atyre që kanë hyrë në sitën e Vetting-ut duke bërë pyetje që kanë ndikuar edhe në kalimin apo jo të kësaj prove, por në seancën e sotme të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk ka bërë pyetje për Du-

manin. "Kam marrë pjesë në 25 çështje dhe kjo është hera e parë që s'kam asnjë pyetje. Zoti Dumani qenka me fat", u shpreh Jacobs.

Sa i përket seancës në KPK, ILDKPI ka raportuar se Dumani ka bërë deklaram të saktë të pasurisë dhe se nuk ka bërë fshehje dhe ka burime të



ligjshme financiare. "Dumani zotëron apartament në Yzberisht blerë në 2015. Përputhen deklaramet me dokumentat përfshirë edhe të dhënat e drejtorisë së pastrimit të parave që transaksionet i konsideron të sakta dhe pa probleme. Ai ka deklaruar se banon në një shtëpi të prindërve të gruas dhe apartamentet e tij i ka lënë me qira. Komisioni thotë se Dumani nuk ka paguar tatimin për qiratë, por ka sjellë prova që do të shqyrtohen. Nuk rezulton të ketë dyshime për përfshirje në aktivitete të paligjshme. Deklaramet e Dumani përputhen me dokumentat e administruara nga institucionet. Pagesa është bërë në dy këste 9 mijë euro cash ngakursimet, 42 mijë euro (ose 50 mln lekë) kredi kësti i dytë. Dumani ka pronësi një

apartament me vlerë 50 mijë euro, ku 5 mln lekë i ka marrë kredi. Apartament blerë në 2006. Ai zotëron një sipërfaqe 29 metra katrore ambient (zyre). Blerë në shumën 28 mijë euro. Dokumentat përputhen me dokumentat në hipoteke KPK: DSIK konstaton përshtatshmërinë e Dumani për të vijuar detyrën." këto ishin disa nga gjetjet e KPK për Dumani.

Altin Dumani pritet të jetë prokurori i ardhshëm i SPAK dhe në listën e KLP u rendit si i pari për këtë garë. Dumani i cili deri më tani mban detyrën si Prokuror i Apelit për Krimet e Rënda shihet edhe si kandidati favorit për drejtimin e SPAK, për shkak se është renditur i pari për aftësisht e larta profesionale.

STRATI

Shoqëria përmbartimore "STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurisë së paluajtshme:

- "Arë", me sipërfaqe 10565 m², ndodhur në Mbrostar-Ura, Fier, me Nr. 73/1 Pasurie, Zona Kadastrale 2636, volumni 5, faqe 18, regjistruar në pronësi të Shoqërisë "ABDURAMANI" sh.p.k., lënë si garanci hipotekore për Tirana Bank sh.a., me kontratë hipoteke nr. 1131 Rep., Nr. 554 Kol., datë 03.05.2012. Çmimi fillestar i ankandit është 89.600 (tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) Euro.

- "Arë", me sipërfaqe 4900 m², ndodhur në Mbrostar-Ura, Fier, me Nr. 36/14 Pasurie, Zona Kadastrale 2636, volumni 12, faqe 126, regjistruar në pronësi të Shoqërisë "ABDURAMANI" sh.p.k.. Çmimi fillestar i ankandit është 61.600 (gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) Euro.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 13.08.2019.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

SHPLLJE ANLANDI

Shërbimi Përmbartimor "Qeva shpk" shpall për shitje në ankand pasurinë e paluajtshme "Apartament" me sipërfaqe 100 m², me nr. pasurie 5/68+1-4, vol.5, faq.159, e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8582, Lagja nr. 5, Rruga Unazë, Përroi i Çaprazit Pogradec. Pasuria shpallet për shitje me Vlerë fillestare 4.965.000 (Katërmiljon e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Ankandi zhvillohet ditën e Hënë në datë 26 Gusht 2019

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagja Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec ose të kontaktojnë ; Cel:0672036006, E-mail: shoqeriaqeva@gmail.com

GENC KONDI
TIRANE

Ministria e Financave do të prezantojë zyrtarisht sot projektligjin e ri të fiskalizimit, që synon të sjellë një mënyrë të re të raportimit të shitjeve dhe blerjeve nga bizneset. Me ligjin e ri, që duhet të hyjë plotësisht në fuqi vetëm në vitin 2021, bizneset do të lëshojnë fatura elektronike, të cilat do të regjistrohen në kohë reale nga organet tatimore nëpërmjet internetit.

RISIA

Për shitjet cash, mendohet që do të jenë faturat elektronike, që do të zëvendësojnë kuponin tatimor. Të gjitha shitjet do të raportohen në kohë reale në sistemin e administratës tatimore dhe jo më në fund të ditës, siç ndodh sot. Platforma elektronike e faturave do të mundësojë kryqëzimin e informacionit dhe ndjekjen e rrugës së produktit që nga prodhuesi apo importuesi e deri te konsumatori final. Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila është edhe nismëtarja e propozimit për sistemin e ri, kjo do ta bënte më të lehtë gjurmimin dhe zbulimin e evazionit fiskal dhe do të pakësonte nevojën për kontrolle fizike tek bizneset.

Aktualisht, bizneset më të vogla i plotësojnë faturat me dorë, nga blloku i faturave tatimore që blejnë nga Tatimet, ndërsa subjektet e mëdha kanë të miratuara nga Tatimet modele faturash elektronike, të cilat u mundësojnë të printojnë faturat direkt. Në fund të çdo muaji, bizneset i deklarojnë faturat në librat e shit-blerjes. Mbi bazën e xhiros së deklaruar kështu, ato paguajnë TVSH-në (ose kërkojnë kreditim TVSH-je), ndërsa kasa fiskale raporton në mbyllje xhiron ditore. Me këtë sistem, bizneset kanë mundësi që të shtynë deklarimin e faturave (psh kur nuk kanë mundësi të paguajnë TVSH-në).

Me sistemin e ri, bizneset

Ndryshojnë rregullat për kasat fiskale, sot prezantimi

Sistemi i ri do të realizojë raportim në kohë reale të shitje-blerjeve



Deklarimi

Aktualisht, bizneset më të vogla i plotësojnë faturat tek blloku që u japin Tatimet, ndërsa subjektet e mëdha kanë të miratuara nga Tatimet modele faturash elektronike. Me sistemin e ri, bizneset do të lëshojnë vetëm fatura elektronike



do të lëshojnë vetëm fatura elektronike. Për subjektet që janë biznes i vogël, procedurat do të jenë më të thjeshtuara. Bizneset duhet të regjistrojnë të dhënat e kërkuara dhe sistemi i Administratës Tatimore do të gjenerojë shifrën e operatorit, i cili do të shoqërohet me numrin e tij personal të identifikimit, nëse operatori është

Pajisjet

Sistemi mbështetet tek një program, që mund të përdoret edhe përmes kompjuterëve ose celularëve. Kasa nuk do të jetë e detyrueshme dhe printimi i faturave bëhet duke lidhur një printer me kompjuterin apo celularin



person fizik, ose me numrin e identifikimit tatimor, nëse është person fizik që ushtron veprimtari kontabël.

APARATURAT

Sistemi i ri nuk dotëmbështetet më domosdoshmërisht tek kasat fiskale, por tek një program ose aplikacion, që mund të përdoret edhe përmes

kompjuterëve të zakonshëm apo aparateve celularë. Kasa nuk do të jetë e detyrueshme dhe biznesi mund të zgjedhë t'i printojë faturat duke lidhur një printer me kompjuterin apo celularin. Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, aplikacioni do të ofrohet lirisht nga çdo kompani e specializuar, që do të ketë dëshirë ta bëjë këtë, pasi është certifikuar më parë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Parashikohet që kostoja vjetore e shërbimit për këtë aplikacion të jetë e ngjashme me koston aktuale të mirëmbajtjes së kasës fiskale.

FIRMA ELEKTRONIKE

Për të lëshuar faturat elektronike, të gjitha bizneset do të duhet të pajisen detyrimisht në nënshkrimin elektronik. Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pajisja me nënshkrimin elektronik

SI DO TË KRYHET PROCESI I RI I FISKALIZIMIT NGA BIZNESET

Pajisje me certifikatë nga AKSHI

Pajisje në treg me pajisje elektronike të faturimit ose pajisje tjetër, e cila përmban një program softueri që mundëson nënshkrimin elektronik të elementeve të faturës dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave me Administratën Tatimore

Nxjerrje e aktit të brendshëm (që përcakton mënyrën e numërimit të faturave dhe përpilon listën e vendndodhjes/vendndodhjeve ku ushtrohet veprimtaria ekonomike)

Përshtatje e përmbajtjes së faturës me rregullat e Administratës Tatimore

Afshim i njoftimit në secilën pajisje të faturimit ose në një vend tjetër të dukshëm në vendndodhjen e biznesit, që tregon detyrimin për të lëshuar faturën, si dhe detyrimin e blerësit për marrë dhe ruajtur faturën

Dërgim i të dhënave në Administratën Tatimore për vendndodhjen e biznesit në të cilin kryhet veprimtaria ekonomike, operatorët dhe mirëmbajtësi i softuerit

Kryerje e vërtetimit të dëftësave në Administratën Tatimore

Nxjerrje e aktit të brendshëm në lidhje me maksimumin e arkës

ligjërisht është detyrim edhe sot, me qëllim dorëzimin e deklarimit elektronik nga biznesi. Administrata tatimore ka toleruar në këtë pikë dhe i pranon deklaratimet edhe pa të; por, nga momenti që faturat do të jenë elektronike, detyrimi për nënshkrim elektronik duhet të zbatohet. Pajisja me nënshkrim elektronik bëhet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe, aktualisht, kushton 4 mijë lekë në vit.

KUFIRI I ARKËS


Ligji vendos dhe kufizime për maksimumin e arkës që mund të mbajë një biznes, ndërsa pjesa tjetër duhet derd-

hur në bankë. Maksimumi i arkës është shuma maksimale e parave në dorë që një biznes mund të mbajë në arkë në fund të orarit të punës. Maksimumi i arkës përcaktohet me një akt të brendshëm dhe përmban subjektet mikro, personat fizikë 150.000 lekë, subjektet e vogla 500.000 lekë; subjektet e mesme 800.000 lekë dhe subjektet e mëdha 1.700.000 lekë. Përtej kësaj shume, subjekti që lëshon faturë detyrohet që paratë në dorë, mbi nivelin e caktuar maksimal të arkës, që ka pranuar gjatë ditës mbi çfarëdo baze, të paguajë në llogari në bankë në të njëjtën ditë, por jo më vonë se ditën e ardhshme të punës.

Efektet

TIRANE

Ligji i ri rregullon disa çështje themelore në aktivitetin fiskal të bizneseve: detyrimin për të lëshuar faturë në tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, subjektet e lëshimit të faturës, përmbajtjen e faturës, procedurën e lëshimit të faturës, detyrimin për të aplikuar faturën elektronike në transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe në procedurat e prokurimit publik, zbatimin e procedurës së fiskalizimit të faturës, regjistrimin e prodhuesve dhe mirëmbajtësit e softuerve për lëshimin e faturave, pro-



cedurën për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave të lëshuara, detyrimin për të lëshuar faturë shoqëruese dhe zbatimin e procedurës së fiskalizimit e

faturës shoqëruese dhe dispozita të tjera thelbësore për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji.

Kjo zgjidhje ligjore mendohet se mundëson transparencë më të madhe, rritje të të ardhurave të përgjithshme tatimore dhe ulje të evazionit fiskal, si dhe kontribuon në ngritjen e ndërgjegjësimit për të paguar tatimet nëpërmjet të dhënave të specifike të siguruara nga Administrata Tatimore, ndër të tjera, edhe me qëllim parandalimin e pastrimit të parave. Administrata Tatimore do të ketë

informacion dhe pasqyrim për secilën faturë të lëshuar dhe të paguar me para në dorë ose në mënyra tjera, në kohë reale, nëpërmjet një lidhjeje interneti me tatimpaguesin, institucionet financiare ose ndërmjetësit financiarë.

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë me anë të këtij sistemi të ri përshpejton dhe automatizon proceset e punës, ul kostot e biznesit, realizon kursime të konsiderueshme dhe potencialisht krijon një vlerë të shtuar në veprimtarinë e biznesit, si dhe në administratën shtetërore.

Pse ndryshon sistemi i deklarimit të transaksioneve?

Përveç kësaj, Ministria e Financave ka njohur rëndësinë e nevojës për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me Direktivën e Këshillit 2014/55/KE dhe Direktivën e Këshillit 2006/112/KE, për arsye të nevojës për të reduktuar dhe eliminuar pengesat në tregtinë ndërkufitare në Bashkimin Evropian. Në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, aktualisht është duke u përdorur një standard i përbashkët evropian i Komitetit Evropian për Standardizim (CEN), datë 28.06.2017, EN 16931-1: 2017, Fatura Elektronike, për mod-


elin e të dhënave semantike të elementeve bazë të faturës elektronike ("standardi evropian për lëshimin e faturave elektronike"). Në këtë standard janë përcaktuar elementet bazë, të cilat fatura elektronike duhet gjithmonë të përmbajë, duke lehtësuar dërgimin dhe marrjen e faturave elektronike ndërmjet sistemeve të bazuara në standarde të ndryshme teknike, me qëllim të heqjes ose reduktimit të pengesave për tregtinë dhe sigurimin ndërkufitar të inter-operabilitetit semantik dhe për rritjen e sigurisë ligjore.

Shpërndahet fondi financiar dhe fondi fizik nga toka në dispozicion

Emrat e përfituesve të 206 mijë eurove dhe 56 hektarëve të kompensuar

ATP njofton se aktualisht ka përfunduar shqyrtimin e 11 aplikimeve, me objekt kompensimin financiar dhe kompensimin fizik nga fondi i tokës në dispozicion të ATP-së, për pronën e njohur me vendimet e ish KKKP-ve. Shqyrtimi dhe vlerësimi i këtyre aplikimeve është bërë sipas të gjitha kriterëve të përcaktuar në ligjin nr. 133/2015 për "Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" dhe VKM-në nr. 223 datë 23.03.2016 për "Përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave" (i ndryshuar).

Nga aplikimet e shqyrtuara deri më tani, rezultojnë 10 aplikime, vendimet e të cilëve përfitojnë kompensim financiar dhe fizik nga fondi i tokës në dispozicion të ATP-së, sipas kriterëve të përcaktuar në VKM nr. 223 datë 23.03.2016 për "Përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave" (i ndryshuar). Për 1 aplikim,



është vendosur përfundimi i procedimit administrativ.

Vlera e fondit financiar të shpërndarë është 25.225.602,8 lekë. Kurse sipërfaqja e kompensuar fizikisht nga fondi i tokës është 563 364,3 m² (56,3 ha).

Subjektet, të cilët kanë aplikuar apo do të aplikojnë për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të vlerësuar financiarisht, do të trajtohen me kompensim vetëm pasi të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ i kërkesës dhe gjithë dokumentacionit të depozituar nga ana e tyre.

Procesi i aplikimit dhe ekzekutimit të vendimeve

përfundimtare të vlerësuar financiarisht për vitet 1993-2013 është një proces i vazhdueshëm dhe i hapur për të gjithë subjektet.

ATP fton të gjithë subjektet e vendimeve përfundimtare të vlerësuar financiarisht, që të paraqiten pranë zyrave të saj, për të aplikuar duke plotësuar dhe depozituar dokumentacionin përkatës, sipas kriterëve të përcaktuar në VKM-në nr. 223 datë 23.03.2016 për "Përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave" (i ndryshuar).

LISTA E APLIKIMEVE TË SHQYRTUARA, PËR VENDIMET QË PËRFITOJNË KOMPENSIM FINANCIAR DHE KOMPENSIM FIZIK NGA FONDI I TOKËS NË DISPOZICION TË ATP-SË

LISTA E APLIKIMEVE, PËR VENDIMET QË PËRFITOJNË KOMPENSIM FINANCIAR DHE KOMPENSIM FIZIK NGA FONDI I TOKËS NË DISPOZICION TË ATP-SË									
Numër rendor	VENDIMI I KKKP ose ZRKKP				SUBJEKTI I SHPRONËSUAR	Aplikimi		PËRFAQËSUESI ME PROKURË	QARKU
	Nr.	Data	Muaji	Viti		Numër dosje	Data e hapjes se dosjes		
1	7	1	9	1993	Jorgji Basko	4	08.01.2019	Aferdita Kola	Vlorë
2	411	16	5	1994	Zamir Marika, etj	39	24.01.2017	Lulzim Marika	Tiranë
3	7	25	4	1995	Aqif Kurti	1104	14.09.2017	Artur Kurti	Tiranë
4	210	7	7	1995	Sami Vrioni	1214	12.11.2018	Aleksander Moisiu	Tiranë
5	1026	25	8	1995	Milto Zotka	175	29.03.2018	Zhuljeta Zotka	Korçë
6	109	19	9	1995	Osman Hoxha	152	19.03.2018	Osman Hoxha	Korçë
7	90	18	10	1995	Andon Mato	803	24.05.2018	Lenica Uka	Vlorë
8	90	18	10	1995	Sotir Zaharia	82	14.02.2019	Desdemona Sopiqoti	Vlorë
9	97	24	11	1995	Muharrem Zenuni	116	02.03.2018	Agim Çeka	Durrës
10	33	20	12	1995	Ramazan Shima	1214	13.10.2017	Alketa Balla	Fier

LISTA E APLIKIMEVE, PËR TË CILAT ËSHTË VENDOSUR MBYLLJE PROCEDIMI ADMINISTRATIV									
Numër rendor	VENDIMI I KKKP ose ZRKKP				SUBJEKTI I SHPRONËSUAR	Aplikimi		PËRFAQËSUESI ME PROKURË	QARKU
	Nr.	Data	Muaji	Viti		Numër dosje	Data e hapjes se dosjes		
11	921	10	4	1995	Haxhire Malo Ferhati	632	06.06.2017	Nexhmi Cufja	Shkodër



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE REQUEST FOR BIDS Small Works (Two-Envelope Bidding Process)

Employer: Albanian Development Fund (ADF)
Project: Regional and Local Roads Connectivity Project (RLRCP)
Contract title: "Reconstruction of the road "Fier - Seman", Lot 1"
Country: Albania
Loan No.: IBRD loan 8850-AL
RFB No: RLRCP/1/1.3/2018
Issued on: July 30, 2019

- The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Regional and Local Roads Connectivity Project (RLRCP), and intends to apply part of the proceeds toward payments under the following contract.

Albanian Development Fund (ADF) is the Project Implementing Agency for the "Regional and Local Roads Connectivity Project (RLRCP)" Project.

- ADF now invites sealed Bids from eligible Bidders for:

RLRCP/1/1.3/2018, "Reconstruction of the road "Fier - Seman", Lot 1". The construction period is 18 months. The Project consists of the reconstruction of the first lot of Fier – Seman road 7.6 km, in the Municipality of Fier.

The proposed reconstruction will not change the road alignment. However, the cross section will be widened and road works will consist of sand-gravel sub base, crushed stone base, bituminous conglomerate, and binder/wearing courses (hot mixed asphalts).

In addition to drainage works and ensuring the functionality of irrigation system alongside the road, the project includes the construction of two new bridges and the rehabilitation (wide and retrofitting) of two others.

The Site is located at Fier municipality.

- Bidding will be conducted through international competitive procurement using Request for Bids (RFB), Small Works (Two-Envelope Bidding Process) as specified in the World Bank's "Procurement Regulations for IPF Borrowers" July 2016 ("Procurement Regulations"), and is open to all eligible Bidders as defined in the Procurement Regulations.

- Interested eligible Bidders may obtain further information and inspect the bidding document during office hours 10:00 to 14:00 hours at the address given below.

- The bidding document in English may be purchased by interested eligible Bidders upon the submission of a written application to the address below and upon payment of a nonrefundable fee of 100 Euro. The method of payment will be direct deposit to the ADF account, at Union Bank, as follows:

Name of the Bank: UNION BANK –Tirana, Albania
Name of account: "Llogari Projekti ADF"
IBAN CODE: AL47 2141 1106 0117 2854 6403 0120
Client number: 285464
The document will be sent by e-mail or dispatched.

For the direct deposit, the Bidder should provide Bank' payment receipt to ADF. Upon receipt of appropriate evidence of payment of the non-refundable fee, the documents will promptly be dispatched. In addition, if requested, the documents can be dispatched electronically after presentation by the prospective tenderer of an appropriate evidence of payment of the non-refundable fee. In the event of discrepancy between electronic and hard copies of the documents, the hard copy shall prevail.

- Bids must be delivered to the address below on or before **September 13, 2019, 11:00 hrs.** Electronic bidding will not be permitted. Late Bids will be rejected. The outer Bid envelopes marked "ORIGINAL BID", and the inner envelopes marked "TECHNICAL PART" will be immediately publicly opened in the presence of the Bidders' designated representatives and anyone who chooses to attend, at the address below. All envelopes marked "FINANCIAL PART" shall remain unopened and will be held in safe custody of the Employer until the second public Bid opening.

- All Bids must be accompanied by a bid security in the amount of 300,000 US\$, or its equivalent in a convertible currency (using the Bank of Albania official exchange rate on the date of publication of the Specific Procurement Notice.

- Attention is drawn to the Procurement Regulations requiring the Borrower to disclose information on the successful bidder's beneficial ownership, as part of the Contract Award Notice, using the Beneficial Ownership Disclosure Form as included in the bidding document."

- The addresses referred to above are:

For further information and inspection of the bid document:

Albanian Development Fund
Address: Rr. "Sami Frasheri", Nr. 10, Tirana, Albania
Contact name: Ms. Manjola Dhamo
Second Floor
Tel: +355 4 22 35 597/8
Fax: +355 4 22 28 548
E-mail: adf@albaniandf.org; mdhamo@albaniandf.org
Web site: www.albaniandf.org

For Bid submission:
Albanian Development Fund
Street Address: Rr. Sami Frasheri, No. 10
Room number: Protocol Office
City: Tirana
Country: Albania


For Bid opening:
Albanian Development Fund
Street Address: Rr. Sami Frasheri, No. 10
Floor/Room number: Fourth Floor.
City: Tirana
Country: Albania

Lirimi i Lul Cakës arrestohet drejtori i burgut të Kosovës

Ministrja Gjonaj denoncon Judmir Shurdhi dhe Llazar Mino. Policia arreston dy zyrtarët



Arrestohet drejtori i burgut të Lushnjës Judmir Shurdhi dhe Llazar Mino me detyrë kartelist pasi akuzohen se liruuan nga burgu 4 muaj e 22 ditë para kohe të fortin e Beratit, Lulzim Caka. Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj përmes një deklarate për mediat njoftoi se pas liritimit nga burgu të Cakës nisi menjëherë hetimi i brendshëm dhe në fund rezultoi se është liruar para kohe. Sipas Gjonajt, Lulzim Caka u lirua 4 muaj e 22 ditë përpara shlyerjes së plotë të dënimit për shkak të përllogaritjes në mënyrë të gabuar nga ana e kartelistit të burgut Lushnjë dhe lëshimit të urdhrit të liritimit në mënyrë të kundraligjshme nga drejtori. Pas arrestimit ata akuzohen për "Shpërdorimin Detyrë" dhe "Falsifikim të dokumenteve". Ndërkohë që Lulzim Caka është shpallur në kërkim për t'a rikthyer për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit.



DEKLARATA E GJONAJ

"Dje në mbremje, me informacion në rrugë operative nga Shërbimi i kontrollit të Brendshëm të burgjeve, jam vënë në dijeni me dyshimin e liritimit para kohe nga IEVP Lushnjë, të të dënuarit Lulzim Caka, i dënuar me 25 vjet heqje lirie për kryerjen e disa veprave penale. Menjëherë sapo kam marrë dijeni, kam urdhëruar verifikimin dhe hetimin e çështjes me grup të

përbashkët hetimi nga Drejtoria e përgjithshme e burgjeve, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje (SHKBB) dhe stafi i Ministrisë së Drejtësisë. Grupi i hetimit, gjatë orëve të natës ka kryer veprimet hetimore dhe procedurale, në administrimin e provave, pyetjen e stafit administrativ, drejtorin e IEVP Lushnjë, kartelistin pranë

këtij institucioni, shqyrtimin e dokumentacionit në IEVP Lushnjë dhe dosjes penale të të dënuarit Lulzim Caka. Në përfundim të këtyre hetimeve, ka rezultuar se shtetasi Lulzim Caka është liruar nga IEVP-Lushnjë 4 muaj e 22 ditë përpara shlyerjes së plotë të dënimit, për shkak të përllogaritjes në mënyrë të gabuar nga ana e kartelistit të IEVP Lushnjë dhe lëshimit të

urdhërit të liritimit në mënyrë të kundraligjshme nga Drejtoria e përgjithshme e burgjeve, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje (SHKBB) dhe stafi i Ministrisë së Drejtësisë Gjonaj.

HISTORIA E LULZIM CAKËS

16 vite pasi qëndroi pas hekurave Lulzim Caka, i njohur edhe si i Forti i Beratit la qelitë e burgut. Caka njihet si vrasësi gjakftohtë ku për hakmarrje pas vrasjes së nënës së tij në vitin 1999 ai ekzekutoi Valter Begën dhe Marigrin Camin. Caka këtë krim e kreu duke u arratisur nga qelia e burgut ku qëndronte për të tjera vepra penale. Pas këtij krimi ai do të qëndronte në arrati dhe emri i tij do të rikthehej në skenë teksa tentoi të vrasë zyrtarët e policisë Gani Malushin drejtorin e Beratit dhe Ilir Ngresin shefin e postit Kuçovë. Karriera kriminale e Cakës daton para vitit 1997 aty ku ai u përfshi në grupet kriminale të Kutallisë në Berat. Lul Caka i njohur edhe si

i afërt i Bujar Sulit, njohur si Loshi i Karbunarës një prej drejtuesve të bandave të Karbunarës dhe zonës Lushnjes Berat arritën të krijonin grupin e tyre. Ky grup operonte në aksin Berat – Fier dhe Berat – Lushnje në grabitjen e udhëtarëve dhe pasagjerëve që përdornin këtë aks përgjatë vitit të mbrapsht 1997. Por ky grup u përfshi në përplasje me familje të fshatit Samiticë e Kutalli nga ku u shënuan viktimat e para mes tyre dhe Pëllumb Eminin. Në formë hakmarrje në 1999 u ekzekutua nëna e Cakës, për të cilën ai më pas kreu dy vrasje. Në vitin 2003 Caka do të sillej në Shqipëri pas ekstradimit nga Italia, por nga ai momenti ai vuri në funksion planin për ti shpëtuar burgimit me 75 vite. Pas ekstradimit ai kërkoi rivendosje në afat dhe rishikim të dënimit, ku gjykata e lartë e më pas ajo kushtetuese i dhanë të drejtë duke rihapur procesin. Për-

fundimisht me një tjetër trupë gjykuese ai u dënua nga apeli i Vlorës me 25 vite burg dhe duke përllogaritur paraburgimit 1 vit në 1.5 vite burg ai arriti të fitoj lirinë më 29 korrik 2019 në moshën 57 vjeçare, por tani duhet të rikthehet për të vuajtur pjesën e mbetur. Po kush ishte Lulzim Caka? Një i ri nga Berati që karrierën kriminale e nisi me vjedhje, grabitje, vrasje e plaçkitje munda të kthehej në personazhin e botës së krimit. Kur ai ishte 33 vjeç u vu nën akuzë për vrasjet e para dhe deri në vitin 1996 kur ai u përfshi në atentatin ndaj Gani Malushit dhe Ilir Ngresit. Caka pas arratisjes në Itali ku qëndroi për një vit e gjysmë u prangos në Foxhia për tu sjellë në Shqipëri ku ndërroi mbi 4 burgje deri sa u vendos në Kosovë të Lushnjes. Një vit para liritimit për llogari të tij një sasi droge u tentua të futej në qelitë e këtij burgu e kamuflluar brenda një sasive mishi, ndërsa pak muaj më pas Caka fitoi lirinë në moshën 57 vjeçare.

OPERACIONI NË ITALI

Shkatërrohet grupi i kokainës Kolumbi Shqipëri-Itali! Në krye të bandës.

Arbër Çekaj, i arrestuar në Gjermani për futjen e sasisë më të madhe të kokainës në vendin tonë, dyshohet të ketë qenë në krye të një rrjeti të trafikut të drogës nga Shqipëria në Novara të Italisë. Janë mediat italiane që shkruajnë për shkatërrimin e një grupi të kokainës që vinte direkt nga Shqipëria në Itali, në një aksion të koduar "Contadino" që identifikoi si trafikantë 26 persona, mes tyre shqiptarë, italianë dhe marokenë. I akuzuar nga drejtësia shqiptare si personi në krye të trafikut të 613 kilogramë kokainë në një kontenier bananesh në pronësi të kompanisë së tij "Arbi Garden", Çekaj tashmë akuzohet se është edhe drejtuesi i një grupi kriminal të shkatërruar në Itali. Mediat italiane kanë zbuluar, se vetëm në një muaj mund të shkonte në Novara

të Italisë nga 10 kilogramë kokainë, 95% e pastër, për një vlerë miliona euro. Droga nisej nga Kolumbia, më tej në Shqipëri, dhe destinacion kishte Italinë, në disa qytete të saj. Hetimet janë mbyllur me nxjerrjen e 26 urdhëve të arrestit, 19 në pranga dhe 7 të akuzuar që janë shpallur në kërkim. Një organizatë komplekse e quajnë mediat italiane, grupin e drogës, hetimet për të cilin kanë nisur prej gushtit të vitit 2017 dhe që kishin çuar tashmë në pranga 4 persona dhe sekuestrimin e 4 kilogramë kokainë, në tre operacione mes 2017-ës dhe 2018-ës. Vendimtar për hetimet ishte fakti që një nga të arrestuarit, shqiptari Elton Shano 38 vjeç në krye të organizatës, vendosi të bashkëpunojë me drejtësinë italiane, duke zbuluar se në përbërje të organizatës kishte

edhe persona mbi të cilët nuk kishte kurrfarë dyshimi se mund të ishin trafikantë. Ata ishin me profesion kuzhinierë dhe parukier shqiptarë. Shqiptari i arrestuar që zbërtheu grupin dhe rolin e anëtarëve, ishte kapur me 3 kilogramë kokainë dhe një pistoletë. Mediat italiane shkruajnë se ai që qëndronte në krye të organizatës, e cila përbëhej edhe nga italianë, 6 prej të cilëve të arrestuar, është tashmë në burg në Gjermani, i akuzuar për trafikun e 613 kilogramëve kokainë në kontenierët e bananeve të kompanisë së tij. Arbër Çekaj u arratis në Gjermani duke i shpëtuar autoriteteve shqiptare dhe u arrestua pak kohë më pas. Kokaina që i është kapur grupit arrin deri në 50 kilogramë. Ajo trafikohej nga Shqipëria në Novara, ku kishte edhe një




qendër magazinimi, dhe më tej shpërndahej në provincat e Pavias, Varese, Alessandria dhe Massa Carrara. Personat që hetuan grupin u shprehën në një konferencë për mediat, se përmes shkatërrimit të këtij grupi të madh kriminal, u arrit të konstatohet gjithashtu, se në qytet ka një kërkesë të madhe për konsumim të

kokainës. Nga 19 të arrestuarit, 7 prej tyre janë shqiptarë, 1 marokenë dhe të tjerët italianë. Operacioni "Contadino" e mori emrin nga pseudonimi me të cilën thirrej një nga anëtarët e këtij grupi trafikantësh që kishte përgjegjësi për magazinimin e lëndës narkotike në Novara.

NGJARJA

Plagoset 60-vjeçari në Korçë, humb kontrollin e motorit dhe del nga rruga



Një aksident rrugor ndodhi në aksin rrugor Korçë-Voskop pranë "Urës së Turanit", ku një 60-vjeçar me inicialet banues në Voskop mbeti i plagosur. 60-vjeçari humbi drejtimin e motorit dhe përfundoi jashtë rrugë. Ai u transportua në Spitalin e Korçës ku ndodhet nën kujdesin intensiv të mjekëve. "Grupi hetimor po punon për të zbardhur rrethanat dhe shkaqet e ngjarjes", thotë policia e Korçës në një njoftim paraprak.

ELTON QYNO
TIRANE

U lirua nga gjyqtari Miri, “i forti” i Burrelit kapet në Londër

Zbardhet dosja e plotë e Gentian Dodës nga korrupsioni i Shkëlqim Miri e telefoni në burg

Eshtë arrestuar në Londër Gentian Doda, njeriu që korruptoi gjyqtarin e Apelit të Tiranës Shkëlqim Miri. Ndalimi i tij është bërë në maj 2019, ndërkohë dje ka filluar Doda po ndiqet penalisht nga prokuroria e Krimeve të Rënda për akuzën e “Korrupsionit aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” kryer bashkëpunimin. Ndërkohë për një tjetër akuzë si ajo e “Futjes ose mbajtjes të sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimeve të vendimeve me burgim” Doda po ndiqet penalisht nga prokuroria e Krujës. Doda, u lirua në muajin nëntor 2017, pikërisht në muajin kur dhe u arrestua gjyqtari i Apelit Shkëlqim Miri, i cili u dënua me pas me 2.6 vite burgim dhe dy sekserët Kujtim Miri dhe Alban Buci. Tre ditë para arrestimit të gjyqtarit Shkëlqim Miri dhe të afërmit të tij Kujtim Miri, mes të dyve, të akuzuar për korrupsion, ka pasur një takim poshtë shtëpisë së gjyqtarit të apelit në lagjen “Myslym Shyri” në Tiranë. Në dosjen hetimore rezultojnë se më datë 7 tetor 2017, Kujtim Miri, është thirrur në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për t’u pyetur si person ndaj të cilit kryen hetime. Kujtim Miri rezultojnë se nuk ka dhënë shpjegime, dhe sapo ka lënë ambientet e prokurorisë është ndjekur nga agjentët e fshehtë. Fillimisht sipas vëzhgimit që i është bërë, ai ka lëvizur në drejtim të Rinastit e pasdite në ora 19:40 po më datë 7 nëntor 2017 ulet në një bar kafe në rrugën “Islam Alla” ku është dhe shtëpia e gjyqtarit dhe aty takohet me këtë të fundit.

30 MIJË EURO NË ZARFIN E BARDHË

Po sipas dosjes, Kujtim Miri mbajtës i numrit të telefonit 0682088xxx si dhe gjyqtari i apelit Shkëlqim Miri mbajtës i telefonit 0692069xxx, janë përgjuar mes tyre teksa kanë folur në datat 23, 24, 25 dhe 26 Maj 2017 si dhe në datat 4,5, dhe 8 qershor 2017 që korrespondon me një ditë pas shpalljes së vendimit në apel, vendim i cili është shpallur më 7 qershor 2017. Një tjetër provë, sipas të cilës gjyqtari Miri ka qenë i përfshirë në këtë akt-korrupтив, është dhe fakti se ai është përgjuar teksa komunikoi me Kujtim Mirin 6 minuta para se ky i fundit, i njohur si sekseri, do të takonte në lokalit në Fushë-Krujë ku u paguan 30 mijë euro shtetasin Alban Bucin dhe shtetasin me iniciale N.A., i cili rezultojnë të jetë dhe vjehri i Gentian Dodës. Këto para u dhanë gjyqtarit Miri që gjykata e Apelit Tiranë të linte në fuqi dënimin me 8 vite burg për akuzën e “Vrasjes me paramendim” mbetur në tentativë dhe “Armëmbajtje pa leje” të dhënë nga gjykata e Burrelit.

“...I DHASHË NJË THES ME DOKUMENTA...”

Mes tyre sipas akuzës më 23 Maj 2017 ka pasur tre telefonata më 18:57 minuta e cila ka zgjatur 72 sekonda, më



21:05 telefonatë që ka zgjatur 32 sekonda dhe një telefonatë prej 1 sekondi. Më pas ka qenë gjyqtari Miri që ka telefonuar të afërmin e tij Kujtim Miri dhe kjo bisedë ka qenë rreth orës 21:36 minuta ka zgjatur 21 sekonda dhe nga pamjet filmike të lokalit të ndodhur në Fushë-Krujë ku është dorëzuar zarfi i bardhë me 30 mijë euro, përkon me kohën që Kujtim Miri ishte në lokal me personat e dërguar nga Gentian Doda. Më 25 Maj 2017 rezultojnë se është përgjuar dhe Alban Buci, shtetas në kërkim po për të njëjtin hetim, dhe mëngjesin e 25 Maj 2017 në ora 09:45 min Buci njofton të afërmit e Gentian Dodës duke u shprehur “...i dhashë atyre një thes me dokumenta...”. Ndërkohë vendimi për lënimin në fuqi të ndryshimit të akuzës nga vrasje në plagosje me pasojë vdekjen ndaj Gentian Dodës ishte planifikuar të jepej në gjykatën e Apelit më datë 6 qershor 2017, por kjo seancë është shtyrë për më datë 7 qershor.

KAPJA E TELEFONAVE BRENDË NË BURG

Ndërkohë në 8 qershor 2017 Gentian Doda, ndiqte me përpikmëri nëpërmjet telefonave që dispononte në burg, çdo lëvizje që kryenin miqtë e tij jashtë qelisë, të cilët një ditë para kishin siguruar me çdo çmim një vendim në leverdi të tij, në Gjykatën e Apelit Tiranë, nga ku ai do rifitonte lirinë. Mirëpo papritur në qelinë nr.10 në burgun e Fushë-Krujës pikërisht në godinën “A” të këtij burgu tre efektive të Grupit të Forcave Operacionale, kanë hapur befasisht derën e dhomës nr.10 për të ushtruar një kon-

troll për sendet e ndaluara.

Kontrolli ishte iniciuar nga vetë Prokuroria e Krimeve të Rënda, e cila po ndiqte me shumë vëmendje veprimet e Gentian Dodës, gjyqtarin të Apelit Tiranë Shkëlqim Miri, kushëririn e tij Kujtim Miri dhe Alban Bucin, të cilët dyshoheshin për korrupsion. Në momentin e futjes në dhomë të tre policëve Arif Osmanaj, Sefedin Shini dhe Admir Ismailaj, i dënuari Gentian Doda ndodhej në krevat gjysmë i shtrirë dhe se në dorë mbante një aparat celular. Menjëherë policët i kanë kërkuar fillimisht të dorëzonte telefonin celular, dhe pasi i dënuari Doda ka zbritur nga krevati, nga ana e policisë është konstatuar se sipër krevatit, ka ishte i shtrirë Doda, ndodhej dhe një telefon tjetër dhe një palë kufje.

I DËNUARI ME BURG PËRJETË MORI PËRSIPËR TELEFONAT

Gjatë përpilimit të raportit të shërbimit i dënuari Gentian Doda pretendoi se aparatet telefonike nuk i kishte të vetat, duke pretenduar se dy telefonat “Black Berry” dhe “HTC” i përkasin të dënuarit me burgim të përjetshëm Gjovalin Kadeli. Megjithatë dy telefonat janë kapur në dorë të Gentian Dodës, ky i fundit ka mundur që të heqë përgjegjësinë nga vetja dhe t’ia kalojë një të dënuari tjetër. Gjovalin Kadeli që vuante dënimin në të njëjtin sektor me Dodën në burgun e Fushë-Krujës, gjatë momentin të kontrollit të policisë, ishte duke u larë në dush. Por pavarësisht se ndodhej në një vend tjetër, Kadeli nuk e ka pasur problem të marrë autorësinë

e veprës penale, duke përfshirë tashmë nga përgjegjësia e krimit Gentian Dodën, që pikërisht në 7 qershor, pra një ditë para kontrollit ishte dënuar nga gjykata e Apelit Tiranë me 8 vite burg për akuzën e “Vrasjes me paramendim” mbetur në tentativë dhe “Armëmbajtje pa leje”.

Me këtë vendim shumë të kontestuar të dhënë nga gjyqtarët Agim Bendo, Flutura Skënderi dhe Shkëlqim Miri, ky i fundit i arrestuar dhe dënuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, si i dyshuar për akuzën e korrupsionit, Doda kishte shlyer ditët e tij të qëndrimit në burg. Por kapja e dy telefonave në dorë një ditë pas këtij vendimi, do të thoshte shtimin e një dënimi tjetër për Gentian Dodën që mund të varioje nga 1 deri në 3 vite burg, ndërkohë paralelisht me nisjen e çështjes hetimore do të thoshte dhe një masë sigurimi “arrest me burg”, duke i vështirësuar lirinë nga qelia Gentian Dodës. I dënuari Gjovalin Kadeli megjithatë në deklaratimet e tij ka pohuar se ishte në dush duke u larë, nuk ka hezituar të marrë përgjegjësinë për dy telefonat. Gjatë pyetjes në prokurorinë e Krujës, e cila një ditë pas kontrollit të qelisë rregjistroi procedimin penal nr.252 për veprën penale të “Futjes ose mbajtjes të sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimeve të vendimeve me burgim”, Gjovalin Kadeli ka deklaruar:

“...dy telefonat dhe sendet e tjera të gjetura gjatë kontrollit në dhomën nr.10 janë të miat. I kisha çuar për ti karikuar dhe për të parë a punon apo jo. Në momentin që i dënuari Gentian



→ DËNIMI

Këto para iu dhanë gjyqtarit Miri që gjykata e Apelit Tiranë të linte në fuqi dënimin me 8 vite burg për akuzën e “Vrasjes me paramendim” mbetur në tentativë dhe “Armëmbajtje pa leje” të dhënë nga gjykata e Burrelit

Doda ka konstatuar në dhomën e tij, më ka njoftuar direkt duke më thënë, hajde merri se mund ti kapin kontrollet dhe ta mbaj përgjegjësinë kot unë. Unë ju përgjigja se do vij menjëherë sapon të mbaroj dushin se jam zhveshur, kur ndërkohë erdhi kontrolli. Dua të shtoj se telefonin HTC, ja kam dhënë disa herë herë për të folur me familjen, ndërkohë i qëndrojnë të gjitha fjalëve të thëna më sipër duke pranuar autorësinë e telefonave”.

Në atë periudhë “Shqiptarja.com” komunikoi me një nga prokurorët e Krimeve të Rënda që kishte urdhëruar këtë kontroll në qelinë nr.10, duke e pyetur se në emër të kujt ishin rregjistruar numrat e telefonit të sekuestruar në dy aparatet celulare të sekuestruar? Prokurori u përgjigj:

“...ne si prokurori e krimeve të rënda nuk kemi asnjë dyshim që telefonat kanë qenë të Gentian Dodës. Celularët i janë gjetur në dorë këtij të dënuari nga një kontroll blic i iniciuar nga ne. Numrat brenda në aparat nga verifikimet tona, dalin që janë të rregjistruar në emër të kushërinjve të Gentian Dodës...”.

Mirëpo për shkak se kjo vepër penale nuk është kompetencë e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, dosja i kaloi për hetime të mëtejshme prokurorisë së Krujës. Teksa çështje e korrupsionit vijonte të ndiqej me shumë interes na Krimet e Rënda, “Shqiptarja.com” mësoi në atë kohë se prokuroria e Krujës ka kërkuar në gjykatën e rrethit masën e “arrestit në burg” për Gentian Dodën, kërkesë e cila është pranuar ng gjykata. Paralelisht në 4 qershor, tre ditë para dhënies së vendimit të gjykatës së Apelit Tiranë, i dënuari Doda fitoi nga gjykata e Krujës një ulje dënimi me 45 ditë, kjo që mjaftonte për ta përgatitur atë për të lënë qelinë. Por Doda brenda muajit ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurisë dhe në 30 qershor 2017 gjykata e Krujës ka refuzuar kërkesën e tij për ndryshimin e masës së “Arrestit në burg”. Përpjekjet e Dodës për të lënë qelinë kanë vijuar sërish ku në 13 shtator 2017 ai kërkuar sërish zëvendësimin e masës së sigurisë, kërkesë e

cila është pranuar nga gjykata e Krujës duke caktuar masën e detyrimit për tu paraqitur në policinë gjyqësore çdo të enën në orën 10:00. Në vendimin e saj gjykata e Krujës ka argumentuar se: “...vepra penale për të dyshuarin Gentian Doda mnuk ekziston...” Sipas kësaj gjykatë i dënuari kishte vijatur dënimin e marrë me 8 vite burgim nga Gjykata e Apelit Tiranë, dhe për inerci duhej ti hiqej dhe masa e sigurimit “arrest me burg” në mënyrë që të bëhej lirim i tij.

Me këtë vendim nuk është pajtuar prokurori i çështjes Bujar Memia i cili ka apeluar vendimin, duke kërkuar rikthimin në qeli të Gentian Dodës, i cili ndërkohë kishte lënë qelinë nr.10 pranë burgut të Fushë-Krujës. Pa kaluar shumë prokuroria ka vendosur të byllë hetimet dhe të dërgojë dosjen në gjykatën e Krujës për gjykim vetëm për shtetasin Gjovalin Kadeli, ndërsa për Gentian Dodën akuzën e ka pushuar. Në kërkesën për gjykim të prokurorisë Krujë argumentohet se: “...nga tërësia e akteve arrijmë në konkluzionin se nuk ka prova të mjaftueshme me qëllim që ndaj shtetasit Gentian Doda, të ngrihet akuzë për veprën penale të Futjes ose mbajtjes të sendeve të ndaluara në burg...”. “...mos-njoftimi në organet përkatëse të sendeve të ndaluara nga ana e shtetasit Gentian Doda lidhet me ndërhyrjen të forcave të policisë...” -thotë prokuroria në kërkesën për gjykim. Por shumë shpejt dosjen prokuroria e ka tërhequr nga gjykata e Krujës, për shkak se nga ana e Krimeve të Rënda u arrestua gjyqtari Shkëlqim Miri, hetim nga i cili ka rezultuar se telefonat përdorshin nga Gentian Doda, i cili informohej nga burgun për çdo lëvizje që po bënin miqtë e tij për korrupsionin e gjyqtarëve të Apelit. “Shqiptarja.com” mësoi në atë kohë se në datën 9 nëntor 2017, disa orë përpara se Krimet e Rënda të arrestonin gjyqtarin e Apelit Shkëlqim Miri, me vendimin nr.1249 treshja e gjyqtarëve Ridvan Hado, Zegjine Sollaku dhe Andi Civici, ka ndryshuar masën e sigurisë nga “detyrim paraqitje” për Gentian Dodën në “arrestit në burg”.



ELTON QYNO
TIRANE

Dosja daneze për Jetmir Kastratin ja si u zbulua grupi i Kokainës

*Përgjimet në automjete, dënimi i Kastratit në Norvegji
e perandoria e pasurisë në emër të kunatit*

Jetmir Kastrati ose siç njihet ndryshe me emrin kosovar Sokol Krasniqi rezultoi të jetë shkodrani që drejtonte dhe financonte një grup të gjerë trafikun, në disa shtete të Europës. Në dosjen e prokurorisë që "Shqiptarja.com" disponon tregohet një tablo e qartë se si ky grup kriminal vepronte në territorin e Danimarkës, Gjermanisë, Hollandës, Suedisë, Belgjikës, Shqipëri e vende të ndryshme të Europës. Grupi i drejtuar nga Jetmir Kastrati kishte si prioritet vetëm trafikimin e lëndëve narkotike kokainë, ku me këtë mall furnizohej në Kolumbi dhe Ekuador, duke e futur më pas në vende të Europës, e shitur deri në Danimarkë dhe Suedi. Rënia në gjurmët e këtij grupi fillimisht është zbuluar nga Qendra Lindore e Hetimit Special të Distriktit Policor të Kopenhagenit në Danimarkë, ku mësohet se në vitin 2015 janë kapur disa korrierë të këtij grupi. Këto indicie janë përforcuar akoma dhe më tepër gjatë viteve në vazhdim, dhe nisur nga kjo situatë prokuroria e Danimarkës, në janar të 2018 ka vendosur të hapë një dosje hetimore, duke kërkuar ndihmën të 6 shteteve europiane, dhe koordinuar veprimet hetimore me EUROPOL. Kjo pasi grupi kriminal i drejtuar nga Jetmir Kastrati kishte një aktivitet të zgjeruar në disa shtete. Gjurmimi në teren i këtyre personave ka bërë që të kuptohet se organizata për-

bëhej nga anëtarë Serbë, Holandeze, Shqiptarë, Suedeze, Danezë, ku shqiptari Jetmir Kastrati konsiderohej të ishte personi që financonte dhe drejtonte trafikun e kokainës nga vendet e Amerikës Latine në drejtim të Danimarkës, Suedisë, Gjermanisë, Belgjikës, Hollandës, Sllovenisë. Nisur nga kjo situatë, prokuroria e Danimarkës ka kërkuar që informacionet e saj, ti ndajë edhe me partnerët Shqiptarë, duke i kërkuar bashkëpunim, dhe përfshirë Shqipërinë në listën e 7 vendeve që ishin përfshirë në investigimin e kësaj organizate. Në 31 maj 2019 Qendra Lindore e Hetimit Special të Distriktit Policor të Kopenhagenit në Danimarkë, ka kërkuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda bashkëpunim dhe nisjen e procedurave hetimore për disa nga anëtarët e këtij grupi që vepronin në Shqipëri. Hetimi në Shqipëri ka filluar për akuzën e "Pastrimit të produkteve të veprës penale" dhe "Grupit të Strukturuar Kriminal" dhe është kontrolluar e administruar nga zv/drejtuuesi i Prokurorisë së Krimeve të Rënda Anton Martini. Nga materiali hetimor i mbëritur



nga Danimarka në Shqipëri, rezultoi se Danezët ishin duke kryer një hetim të gjerë për një organizatë kriminale ku të përfshirë ishin Jetmir Kastrati, Eri Pelinku, Dëfrim Bech, Armando Duçaj dhe shumë persona të tjerë si Nikardo Preka etj. Hetimet kishin zbuluar se pjesën më të madhe të fitimeve të kësaj organizate vinin në Shqipëri, ku menaxhoheshin nga Kastrati ose Sokol Krasniqi. Në Shqipëri vepronte dhe Eri Pelingu ose siç është identifikuar më vonë Eri Elbasani apo Ergys Elbasani. Gjithashtu ky person

mbante dhe pasaportë suedeze me emrin Dëfrim Beck. Pjesë e këtij grupi kriminal është dhe Armando Duçaj ose siç është identifikuar më vonë si Astrit Duçaj i lindur në Tropojë dhe banues në Linz të Tiranës. Pjesë e këtij grupi në rolin e administruerit të pasurisë është dhe kunati i Kastratit, Astrit Beqiri. Gjatë hetimeve ka rezultuar se investitori i ndërtimit të "Pularisë" në emrin e kompanisë "Rens 2015" me vendodhje lagjia buzë lumit Drin, në Bërdicë e Sipërme në Shkodër si dhe disa prona të tjera, dyshohet

se i përkasin Jetmir Kastratit. Por nga rregjistrimi në zyrat shtetërore me qëllim për të fshehur pronësinë reale mbi to, është bërë në emrin e kunatit të tij, Astrit Beqiri. Mirëpo në bisedën e datës 14 dhjetor 2018 të zhvilluar në një autoveturë në Danimarkë, bisedë e cila është përgjuar nga autoritet daneze, midis Jetmir Kastratit alias Sokol Krasniqi dhe mikut të tij Nikardo Preka tashmë i arrestuar, rezultoi se Kastrati shprehet se ka 9000m2 tokë, kompania e tij e ka emrin "Rens", i cili është shkurtimi i emrit të nipit "Arenç" dhe se i ka kushtuar rreth 130 deri në 140 milionë lekë, vetëm përgatitja e godinës ku bëhet fjalë për pularinë në Bërdicë etj. Gjithashtu ka rezultuar se Jetmir Kastrati rezultoi i dënuar në Norvegji në vitin 2012 për veprën penale të "Pastrimit të parave", e për rjedhojë nga frika e identifikimit të pronave në emrin e tij, ka bashkëpunuar me kunatin e tij Astrit Beqiri, duke i kaluar pronat në emër të tij. Beqiri është një person i pa skeduar nga policia dhe prokuroria Shqiptare, dhe nisur nga kjo situatë ai ishte njeriu ideal për të qënë pronar

me letra i pasurisë së Jetmir Kastratit. Por ky i fundit nuk ka parashikuar që mbi Beqirin do lindnin dyshime, për shkak se pasuria që ai mbante ishte shumë e madhe, në një kohë që vetë Beqiri nuk kishte punuar apo të kishte mundësi financiare për të gjeneruar gjithë atë pasuri. Për pasojë prokurorët danezë dhe Shqiptarë kanë ngritur dyshime se Beqiri ishte bërë vegël e Jetmir Kastratit për të pastruar në Bërdicë të Shkodrës, paratë e fituara nga trafiku i drogës në disa shtete. Ndërkohë nga verifikimi i pronave në emër të kompanisë "Rens 2015" ka rezultuar se kjo kompani zotëron një dyqan në Kashar Tiranë, një motor Yamaha, një makinë BMEX5, një makinë Benz Mercedes, një makinë Volkswagen Golf, një automjet "Fiat". Gjithashtu në emër të motrës së Jetmir Kastratit, Amela Beqiri (Kastrati) është i regjistruar një automjet tip "Daimler Chrysler". Po kështu gjatë kontrollit në disa banesa, pikërisht në banesën e Astrit Beqirit në 26 qershor 2019 janë gjetur dhe sekuestruar në total 173 mijë e 500 euro dhe 86 milion e 260 mijë lek të vjetra.

VENDIMI NË DURRËS

Pas 19 ditë në qeli gjykata liron polakun, armën në makinë ia futi bashkëpunëtori i SHISH

Arkadiusz Modrzejewski, biznesmeni Polak i arrestuar në 11 korrik 2019 për akuzën e "Mbajtjes pa leje të armëve", është liruar dje nga gjykata e Durrësit. Polaku, ka qëndruar 19 ditë në qeli, por gjatë kësaj kohe është vërtetuar se ai nuk kishte asnjë lidhje me armën tip pistoletë TT, që policia gjeti në makinën e tij.

Hetimi ka zbuluar se arma ishte futur qëllimisht nga bashkëpunëtori i SHISH në Durrës Graciano Hidri, i cili në këtë veprimtari kriminale ka bashkëpunuar me inspektorin e SHISH në Durrës me inicialet A.S, që ka njoftuar policinë e Durrësit, e cila arrestoi poshtë shtëpisë së tij polakun Arkadiusz Modrzejewski. Por

ky i fundit në asnjë moment nuk ka pranuar autorësinë e kriminit, duke këmbëngulur në policinë e Durrësit, gjykatë dhe prokurorisë se arma e sekuestruar në makinën e tij ishte futur qëllimisht nga bashkëpunëtori i tij në biznes Graciano Hidri. Pas hetimeve të kryera janë siguruar të dhënat dhe provat se arma e



Graciano Hidri

zjarrit ishte futur në makinë nga bashkëpunëtori i SHISH në Durrës Graciano Hidri, i cili e ka bërë këtë veprim si pasojë e dëshirës për tu



Pistoleta e sekuestruar

hakmarrë, pasi mes Hidrit dhe Arkadiusz Modrzejewski, ka pasur një konfliktin për çështjen e kompanisë. Por që prej ditës së shtunë Graciano

Hidri, është arrestuar dhe mbyllur në qeli, ndërsa ditën e sotme gjykata e Durrësit ka liruar nga qelia Arkadiusz Modrzejewski.



VALERIA DEDAJ
TIRANE

Fituesit e Fondit “Krijimtaria letrare për fëmijë” janë shpallur dje nga Ministria e Kulturës. Mes 27 aplikuesve, juria përzgjedhi pesë veprat më të mira në poezi, roman dhe përralla.

Juria që shqyrtoi veprat në këtë garë, përbëhej nga shkrimtarë, përkthyes dhe studiues, si Lili Sula, Virgil Muçi, Erion Kristo, Roven Rrozhani dhe Suela Bala. Ndërsa, emrat e autorëve kanë qenë të fshehur pas kodesh numerike. Juria u njoh me emrat e fituesve vetëm pasi ishte dorëzuar dhe firmosur lista e fituesve. Ministria e Kulturës, Elva Margariti shpërndau certifikata për pesë fituesit.

“Përpara se të hapnim fondin për krijimtarinë letrare, kisha dëgjuar shpesh nga shkrimtarë, botues, por edhe prindër për një mungesë të krijimtarisë letrare për fëmijë, që flasin shqip. Nga njëra anë shkrimtarët që ankoreshin se Ministria e Kulturës nuk i mbështet dhe nuk e nxit krijimtarinë letrare për fëmijë dhe nga ana tjetër prindërit që ankoreshin për mungesën, por edhe cilësinë, që lë për të dëshiruar të kësaj letërsie. Andaj vendosëm, që pikërisht, në ditën e fëmijëve, 1 Qershor ne të hapnim këtë fond, duke ia dedikuar pikërisht atyre. Impakti ka qenë tepër pozitiv. Kemi

“Krijimtaria letrare për fëmijë”, shpallen 5 fituesit e fondit

Juria përzgjedhi pesë veprat më të mira në kategoritë poezi, roman, rrëfenja, përrallë, libër didaktik mes 27 aplikuesve

pasur mbështetjen e të gjitha palëve dhe jam e kënaqur për pjesëmarrjen e lartë, për mënyrën e përzgjedhjes dhe emrat e nderuar që qëlluan të ishin mes fituesve. Jam besimplotë që kjo eksperiencë do të vijojë. Mbështetja jo vetëm shkrimtarët, por nisim krijimtarinë e mirë dhe qasim lexuesin e ri. Mendoj se fushata më e mirë e nxitjes së leximit është në faqet e një libri të mirë”, u shpreh Margariti.

Ndër të tjera ajo ndau me të pranishmit edhe lajmin e rikthimit të Çmimit Kombëtar të Letërsisë për Fëmijë. “Dikur, mes shumë çmimeve të tjera letrare, akordohej një çmim për krijimtarinë për fëmijë, por që më pas hoq. Gjej rastin t’ju them se ne do ta rikthejmë atë Çmim

Kombëtar si një nxitje permanente dhe të qëndrueshme për këtë lloj letërsie, e cila për mendimin tim ka një rol kyç në edukimin brejt të ri. Dashuria për leximin ngjizet në vitet e para të jetës dhe një libër i mire mund ta bëjë këtë”.

5 fituesit ishin Gaqo Bushaka, për kategorinë në poezi, Hysen Kobellari për rrëfenjat, Luan Rama për librin didaktik, Viktor Cenositaj për romanin më të mirë dhe Rudina Çupi për përrallën më të mirë.

Përkthyesi Erion Kristo, anëtar jurie, u shpreh se nuk bëhet fjalë për një konkurs, por për politikë të librit për fëmijë. Ai e quajti risi mbështetjen nga ana e Ministrisë së Kulturës, të kësaj krijimtarie dhe autorëve për fëmijë.

Studiuesja Lili Sula u shpreh se kjo ishte mënyra më e mirë për të sjellë vepra serioze. Ajo tha se nëse e edukojmë sot brezin e ri me letërsi të mirë shqipe nesër do të kemi një lexues të mirë, studentë të mirë dhe qytetarë të mirë.

Suela Bala u shpreh se nuk mund të merremi me lexuesin, nëse më herët nuk do të merremi me shkrimtarin për fëmijë. “nëse do të dimë t’ua servirim mirë materialin, do të rrisim fëmijë të mrekullueshëm”, tha ajo, me shpresën që kjo përvojë të vijojë edhe më tej.

Fituesit vlerësuan Ministrinë e Kulturës për këtë nismë në mbështetje të letërsisë për fëmijë. Fituesit do të shpërblehen me 150.000 lekë.

FITUESIT E ÇMIMEVE PËR FËMIJË

FITON NË KATEGORINË POEZI

Gaqo Bushaka, me motivacionin: “Për mjeshtërinë e vargëzimit të thjeshtë shumë afër botës fëmijore, me tingullim melodik, pastërti gjuhësore dhe larmi tematike”.

FITON NË KATEGORINË RRËFENJA

Hysen Kobellari, me motivacionin: “Për merita të spikatura në qëmtimin, përpunimin dhe sjelljen në një kontekst të ri letrar të një trashëgimie folklorike që kemi nevojë ta kultivojmë tek fëmijët tanë si pasuri identitare”.

FITON NË KATEGORINË PËRRALLË

Rudina Çupi, me motivacionin: “Për kurajën e një narrative me peshë të lartë përmbajtësore për fëmijët, që e sfidon dhe edukon lexuesin me inteligjencën e humorit dhe frymën e lojës, duke kthyer në vëmendje FJALËN”.

FITON NË KATEGORINË E LIBRIT DIDAKTIK

Luan Rama, me motivacionin: “Një tekst letrar që mbart vlera të spikatura didaktike, përmes kultivimit artistik të dijes dhe vlerave kombëtare për fëmijët, me një ligërim të zhdërvjellët e të ilustruar bukur”.

FITON NË KATEGORINË ROMAN

Viktor Canositaj, me motivacionin: “Arrin të mbajë zgjuar interesin e lexuesit të ri, duke ruajtur brenda një strukture të pastër konceptuale dhe gjuhësore, ligërimin artistik grishës dhe formues njëkohësisht”.

TURIZMI

Liqeni i Ohrit shpallet zonë e mbrojtur nga UNESCO

Në datën 5 korrik, Komiteti i Trashëgimisë Botërore shpalli një tjetër Zonë të Mbrojtur pasuri të UNESCO-s. Liqeni i Ohrit, përfshirë pjesën shqiptare mori statusin sit i UNESCO-s, si fryt i punës disa vjeçare të ekspertëve të mjedisit dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me ministrinë e Kulturës në plotësim të dosjes dhe kërkesave për të qenë pjesë e Trashëgimisë Botërore, UNESCO. “Liqeni i Ohrit është një destinacion i ri turistik që ka marketingun më të mirë të mundshëm duke qenë zonë e mbrojtur. Por, po ashtu është një destinacion që na rrit përgjegjësitë për të qenë më pranë rregullave, që OKB ka vendosur. Është shumë e rëndësishme të bësh turizëm, por është shumë e rëndësishme të zbatosh edhe rregullat për të menaxhuar një sit kaq të bukur natyror, për të dhënë gadishmërinë tonë, natyrisht bindjen e dy qeverive tona se do të

bëjmë çfarëdo që të jetë e mundur që ky liqen të vazhdojë të jetë i mbrojtur, të jetë një peisazh i bukur dhe magjepsës, i cili edhe duke u kultivuar për më shumë turizëm, të zhvillohet brenda normave dhe parimeve të trashëgimisë botërore”, tha ministri Klosi.

Nga ana e saj, ministrja Margariti tha se vendimi i 5 korrikut na bën krenarë, që një vend i vogël si Shqipëria arrin të përfaqësohet në UNESCO me disa vlera. “Po bëjmë një punë të rrallë nëpër ministritë tona për të shtuar edhe dosje të tjera. Në vendimin e shpalljes Komiteti i Trashëgimisë Kulturore ka dhënë disa rekomandime, ndaj jemi këtu për ti treguar të gjithëve se ne do të punojmë së bashku për ti përbushur këto rekomandime. Tashmë jemi në fazën e dytë të projektit drejt një qeverisje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të liqenit të

Ohrit, por jo vetëm kjo! Kemi edhe marrëveshje të tjera me partnerët tanë, me Maqedoninë e Veriut kemi nënshkruar në muajin prill ngritjen e qendrave kulturore dhe informative në të dy Republikat, pra ja ku rikthehem edhe njëherë që ky liqen është vetëm një pikë bashkimi e shumë gjërave të tjera që ekzistojnë përreth”, tha ministrja Margariti.

Edhe ministri Klosi shtoi gjithashtu se së bashku me kolegët nga Maqedonia e Veriut, dy qeverive i del detyrë të ngrenë komitete të përbashkëta për të punuar për të ruajtur dhe zhvilluar vlerat e këtij liqeni. “Na del detyrë ta promovojmë, ta vizitojmë ta kthejmë në ekonomi për qytetin. Nga sot, të jemi të gjithë së bashku me një premtim, si përfaqësues të qeverisë shqiptare dhe të Maqedonisë së Veriut për ta pasur edhe këtë pikë si shumë pika të tjera të trashëgimisë sonë natyrore, të trashëgimisë kulturore dhe



historike si pika që na bashkojnë, si pika që dëshmojnë se ne mund të jemi destinacion i mirëfilltë turistik atëherë kur kuptojmë se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, Serbia, Kosova, Bosnje Hercegovina dhe Mali i Zi duhet të paraqiten si një ofertë e përbashkët në tregun e madh botëror të turizmit, atëherë kur duhet të kuptojmë se pasuri të tilla si liqeni i Ohrit duhen mbrojtur, kultivuar dhe zhvilluar me një parim për të qenë këto vlera të trashëgimisë botërore, ashtu të bukura sic janë krijuar e kështu të bukura sic po mbrohen sot”, tha ministri Klosi, nga Pogradeci, ku

u zhvillua aktiviteti “Gjoli” në UNESCO, për të bërë për herë të parë publike përfitimet dhe detyrimet që kanë dy qeveritë për të vijuar punimet në përmbushje të kushteve të kërkuara natyrore, historike dhe kulturore për të qenë pjesë e listës së pasurive të trashëgimisë botërore. Në aktivitet ishin të pranishëm edhe ministri Maqedonas i Mjedisit dhe Kulturës, të cilët gjithashtu vlerësuan rëndësinë e përfshirjes së liqenit të Ohrit në UNESCO për dy vendet tona, duke shprehur edhe angazhim për të vijuar punuar bashkarisht në ruajtjen dhe promovimn e tij.

Paradë

FJALËKRYQESH



NGA
KADRI
VOKOPOLA

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 36 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

- Mavijosur pjesërisht
- Një mund të jetë i thotë gjërat qartë.
- Një mund të jetë i kondicionuar.
- Shkojnë me kërkesa.
- Brian i Roxy Music.
- Ekstre me jeep.
- Në krye të notarëve.
- I njëmbëdhjetë në vit.
- Të parat në aviacion.
- Gjysmë e foljes.
- Thomas Mann.
- Është tekë.
- Qe amazona që u vra nga Akili.
- Haset pa kufij.
- Janë botimet si revistat.
- Nuk qarkullon më në Itali.
- Është shkrim... i bukur.
- Ishte ekzekutiv aparta bashkisë
- Inicialet e Ravel.
- Carol aktore.
- Shteti i « luanëve të pamposhur » në futbol.
- Paul Klee.
- Jones këngëtare.
- Fund kursi.
- Mirë në qendër.
- Harem pa ekstreme.

- Janë ata që dinë të flasin.
- Një nga emrat e Cervantes.
- Kush bën ve në lojë.
- Inicialet Taylor aktore
- Është i thyer në mal.
- Kush është është i zbehtë.
- Një pije bukanierësh.
- Një ndërmjetës në pazar.

VERTIKAL

- Komisari i Andrea Camilleri-t.
- Një fjalë për aty pranë.
- Maazel dirigjent.
- Mara e Domenica in.
- Janë binarët.
- Stacion televiziv gjerman.
- Një grimcë me bërthamë.
- Është ndenjëse zbururimi.
- Është greminë.
- Mata spiune.
- Pak kokëfortë.
- Me to bëjnë triko.
- Kapet në kufij.
- Një fjalë sin pafund, pakufij.
- Bëhet kundër një dënimi.
- Inicialet e Rohmer.
- Janë teknike në kriza politike
- Një pjesë e studimeve.
- Mbyllin krahun.
- Është shtet afrikan.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

E	L	I	P	S	E	T		R	P	T		B	G	T	T		
V	E	T	R	A	T	A	T		R	A		R	E	R	U	M	
I	D	E	A	L	E	T		V	E	L	L	I	M	E	T		
A	P	L	R	S	I	M	B	O	L	I	K	E					
A	E	S	A	M	I	S	I	O	N	A	R	E	K				
N	I	R	O	P	A	L	E	S	T	I	N	A	P	A			
A	N	T	B	I	L	E	T	A		T	T	I	P				
I	D	G	O	L	A	N		D	I	E	A	R	I				
S	E	N	A	T	O	R	I	R	I	Z	F	R	A	T			
K	A	T	E	T	I	D	E	M	O	K	R	A	T	E			
L	S	E	R	K	E	N	D	E	T	A	M	E	N				
P	E	R	S	O	N	E	L	I	R	I	M	T	I				

- Fillojnë romanin.
- Mund të jenë çnjerëzore.
- Një luftëtar palestinez.
- Një zakon i keq.
- Gjipali këngëtar lirik.
- Një gri është pinot.
- Bëhet për të kërkuar edhe një punë.

- I ka të ndryshme darka.
- Mbreti i Shakespeare
- Marsi i akejeve
- Mund të jenë autonome të tilla.
- Një fjalë si afër.
- Kështu është një darkë nën dritën elektrike
- Mbyllin një manastir

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGË 19

		3		7		9			
	4	9	8		6	2	1		
1	8						4	3	
	9		3	8	7		2		
3			6		9				4
	6		5	4	1		7		
9	1						8	2	
	3	7	2		8	4	9		
		8		9		1			

7	1	5	2	3	8	4	9	6
6	2	3	1	9	4	7	8	5
9	4	8	6	7	5	1	3	2
5	8	7	4	6	3	2	1	9
4	3	2	9	5	1	8	6	7
1	6	9	7	8	2	5	4	3
8	5	1	3	2	6	9	7	4
2	9	6	8	4	7	3	5	1
3	7	4	5	1	9	6	2	8

FJALËKRYQI SPORTIV

1	2		3	4				5	6		7	8	9
10				11				12			13		
			14	15			16	17					
							19			20			21
22		23		24			25				26		
27			28				29			30			
31			32				33			34			
		35				36		37	38		39		40
41				42	43							44	
		45											

HORIZONTAL

- Skuadra e Blues në Premier League.
- Larg në kufij.
- Rrallë është përgjysmë
- Dy asa
- Oliver Hardy
- Ray "Sugar" ish-kampion i ringut
- Robert bomber polak
- Një nur bukurie
- Fise pa fe
- Ekstre me durim

- Janë personale në basket
- Franck te Milan
- Lumë në Itali
- Një mund të jetë unik
- Dy romake
- Ndahen në barazim
- Rikard Ljarja
- Është shahu i fundit
- Antonio Banderas.
- Luhën me klarinetë.
- Personazhi në foto
- Personazhi në foto

VERTIKAL

- Inicialet e Ancelotti-t.
- ... 9000, kompjuteri që u çmend te 2001-Odissea në hapësirë.
- Joachim trainer gjerman
- Një i fundit është mat
- Hamilton pilot
- Thashetheme në Hollywood
- Ka rivale Mediaset
- Robert Redford
- Lallana te Liverpool
- Kështu fillon loja

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

M	A	R	M		S	S	P		P	A	N	I	G
K	E	B	A	T	A	L	A	N	T	A			
I	N	T	E	R	N	A	Z	I	O	N	A	L	E
A	L	I	N	O	T	R	E	Z					
A	N	G	E	L	I	M	A	R	I	A			
A	T	E	H	A	S	A	N						
I	E	O	L	I	N	A	P	I	D				
A	R	E	N	I	N	A	P	I	D				
A	R	O	N	R	A	M	S	E	N				

- Inicialet e Kidman
- Hazard fantazist belg
- Lauda ish-pilot
- Një si kaproll
- Sorvino aktore
- Teke drite
- Një top në rrjetë
- Është golashënuesi
- Pak matematikë
- Dy anët e një elementi
- Janë zyrtaret për pole position
- Immanuel filozof.
- Portiku i Zenonit
- Algjeria në tabela
- Krimi pa çifte
- Garazhi ne Formula 1
- Agjenci Rajonale Has
- Ente Sportive Kavaje
- Fund tuneli
- Fillojne nazet
- Kufizojnë takimin
- Sapo fillojnë

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

2	7	3	2	12		12	2	6	2	8	2		
7	2	4		15	2	1	8			20	2	7	1
2	6	2	14		11	14		14	5	8	1	6	
4	1	8		19	1	4		5	8	1		4	
11	8		16	1	4	1	8	10	3		9	17	
3		11	5	8	3	6	5	4		11	1	12	
	11	2	4	2	15	2	8	2		2	11	14	
11	5	8	3	6	5	4		6	4	17	16	1	
17	4	2	6		8	1	19	V		4	3	6	
4	2	15		6		6	1	E		4	1	6	
2	7		11	1	6		6	T	1	11	1	8	2
6	1	14	1		1	4	3	I	10	2	8	3	

PËRGJIGJE



SHKRONJA E
NJËJTË PËR
NUMËR TË NJËJTË

K	A	L	E		C	U	M		G	E	L		
O	U		M	E	K	A	N	I	K	I			
N		L	I	T	E	R	A	T	U	R	A		
C	A	I	N		C	A	N	O	N		R	N	
A	G	N	E	S		C	I	L	A		I	O	
R	A	D		S		M	O	T	R	A	T		
T	O	R	E	L		E	G	A		N	A		
E	U	R	E	K	A		J		M	A			
T	E	M		L	U	G	I	N	A		N		
E	A	M	O		A	K	U	L	L	I			
I	T	K	A	M	A	T	E		L	E	K		
M	A	C	E	T		L	I		M	T	K	E	

VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR! THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!




BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë
- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War




BUNK'ART 2

- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist
- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



Ku ndodhet BUNK'ART 1?
Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 16:00 të hënë & të martë pushim



Ku ndodhet BUNK'ART 2?
Rr. Abdi Toptani
(përballë Bashkisë) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 18:00 çdo ditë

www.bunkart.al / info@bunkart.al

Prenotime / Reservations: +355 (0) 67 20 72 905

